



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË  
ARSIMIN E LARTË**

**Raporti i Vlerësimit Periodik Institucional i  
Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë**

**GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM:**

- |    |               |         |
|----|---------------|---------|
| 1. | Elvin Gjevori | Kryetar |
| 2. | Gert Guri     | Anëtar  |
| 3. | Arben Mehmeti | Anëtar  |

Korrik 2022

## Përmbajtja

Rreth këtij vlerësimi.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Konteksti i këtij vlerësimi.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Raporti përmbledhës.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Përmbledhje e gjetjeve.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Rekomandime.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Pohimi i veprimeve të ndërmarra.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Gjykime përmbledhëse për çdo Fushë Vlerësimi.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Gjykim i përmbledhur.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Raport i detajuar.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Fusha e vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Gjetje.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Praktika e mirë.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Pikat e dobëta.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Rekomandime.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Pohimi i veprimeve të ndërmarra.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Gjykimi.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Fusha e vlerësimit 2: Burimet.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Gjetje.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Praktika e mirë.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Pikat e dobëta.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Rekomandime.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Pohimi i veprimeve të ndërmarra.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Gjykimi.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Fusha e vlerësimit 3: Kurrikula.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Gjetje.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Praktika e mirë.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Pikat e dobëta.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Rekomandime.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Pohimi i veprimeve të ndërmarra.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Fusha e vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>Bookmark not defined.</b>	
Gjetje.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Praktika e mirë.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Pikat e dobëta.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Rekomandime.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Pohimi i veprimeve të ndërmarra.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>

Fusha e vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Gjetje.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Praktika e mirë.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Pikat e dobëta.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Rekomandime.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Pohimi i veprimeve të ndërmarra .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Lista e evidencave.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Lista A: Lista e evidencave .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Lista B: Mbledhjet e zhvilluara gjatë vizitës .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Lista C: Lista e evidencave të paraqitura gjatë vizitës .	<b>Error! Bookmark not defined.</b>

## Rreth këtij vlerësimi

Qëllimi i përgjithshëm i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë në çfarë shkalle IAL-ja përmbush Standardet Shtetërore Shqiptare të Cilësisë, që kanë hyrë në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi Institucional është procesi i vlerësimit nga grupi i vlerësuesve, që përbëhet nga një ndërthurje e vlerësuesve ndërkombëtarë dhe shqiptarë të caktuar nga ASCAL-i.

Raportet përkatëse nuk shërbejnë vetëm për akreditimin institucional, që mbështetet në shkallën e përmbushjes së standardeve nga IAL-të, por edhe për t'u ofruar IAL-ve, qeverisë shqiptare, publikut dhe studentëve informacion për mënyrën se si IAL-të përmbushin standardet. Ky raport i ndihmon gjithashtu IAL-të të identifikojnë prioritetet që kanë nevojë për përmirësim (procesi që ofruesit e arsimit të lartë zbatojnë për përmirësimin sistematik të cilësisë së ofrimit dhe mënyrave për mbështetjen e të nxëniet të studentëve).

Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri janë grupuar në pesë kapituj, Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre. Ky raport identifikon karakteristikat e praktikave të mira, rekomandimet, pohimet e veprimeve në zhvillim e sipër dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, duke përfshirë gjykimin se në çfarë niveli IAL-ja i përmbush standardet. Format e gjyimit që vlerësuesit mund të japin janë: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur kryesisht; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk janë përmbushur.

Në fund, vlerësuesit do ta përmbyllin punën e tyre duke i rekomanduar Bordit të Akreditimit të ASCAL-it një gjykim të përmbledhur. Gjykimi i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.**

## Konteksti i këtij vlerësimi

Universiteti i Korçës “Fan S. Noli” është një institucion i arsimit të lartë në Shqipëri, i themeluar mbi 50 vite më parë. Historia e tij daton që prej vitit 1971, kur u ngrit për herë të parë si Instituti i Lartë i Bujqësisë. Në vitin 1992, ai u transformua në Universitetin Politeknik të Korçës, dhe në vitin 1994 mori emrin Fan. S. Noli. Që prej fillësës së tij ‘modeste’ në vitin 1971, Universiteti ka pësuar ndryshime strukturore rrënjësore, në të njëjtën linjë me ato të përjetuara në vend pesëdhjetë vitet e fundit, dhe është shndërruar në një qendër kryesore arsimit dhe kërkimi në rajonin juglindor të Shqipërisë.

Universiteti i Korçës (UNIKO) është një institucion publik i arsimit të lartë, i gjendur në pjesën juglindore të vendit. Misioni i Universitetit është të krijojë, përcjellë, zhvillojë dhe mbrojë njohuritë nëpërmjet mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve të tjera arsimore. Universiteti ndjek parimet kryesore të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë. Vizioni strategjik i Universitetit është integrimi i plotë në Zonën Evropiane të Kërkimit Akademik, duke ndërmarrë hapa që synojnë krijimin dhe mbështetjen e standardeve të larta të mësimdhënies, mësimnxënies dhe të kërkimit, për të përmbushur misionin e tij.

Universiteti përbëhet nga katër fakultete, përkatësisht: Fakulteti i Bujqësisë, Fakulteti i Ekonomisë, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, si dhe Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane. Fakultetet ndahen në 15 departamente. Universiteti ka dy Qendra Ekselence, Njësinë për Formim, Kërkim dhe të Nxënimit Gjatë Gjithë Jetës, si dhe Njësinë e Ekonomisë Didaktike Eksperimentale, që ofron kërkime dhe praktika profesionale në bujqësi.

Universiteti ofron 7 programe profesionale studimi, 25 programe studimi të ciklit të parë, 21 programe Masteri Profesional, 3 programe Masteri Shkencor dhe 1 program doktore. Numri aktual i përgjithshëm i studentëve është 2930, të cilët mbulohen nga 154 punonjës akademikë me kohë të plotë dhe 89 punonjës pjesë e personelit akademik mbështetës dhe administrativ.

Universiteti i Korçës i është nënshtruar procesit të parë të vlerësimit të jashtëm institucional në vitin 2016, prej të cilit u akreditua për 5 vjet. Bazuar në procesin e vlerësimit të jashtëm, Bordi i Akreditimit i dha Universitetit një rekomandim: ‘Hartimi dhe zbatimi i strategjisë në kuadër të zhvillimit sistematik të fushave kërkimore të identifikuara si prioritare në Planin Strategjik të Zhvillimit.’ Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi se ky rekomandim është përmbushur nëpërmjet zbatimit të dy dokumenteve, përkatësisht: Planit Strategjik të Zhvillimit 2016 - 2020 dhe Planit Strategjik të Zhvillimit 2022 - 2027.

## Raporti përmbledhës

### Përmbledhje e gjetjeve

#### Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Ngritja e një laboratorit për mësimdhënie hibride **[Kapitulli III, Standardi VII.2]**
- Kurrikula, në disa departamente, si mësimdhënia dhe studimet bujqësore, është përmirësuar në masën 80%, falë vërejtjeve të studentëve dhe palëve të interesit. **[Kapitulli I, Standardi I.1]**
- Një program në fushën e Agrobiznesit ka nisur studime të dyfishta në kuadër të projektit Erasmus+, ku është planifikuar një rritje e ndjeshme e stazheve/praktikave profesionale **[Kapitulli I, Standardi II.4]**

#### Pikat e dobëta

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi pikat e dobëta të mëposhtme:

- Mungesa e mbështetjes financiare të strukturuar për pjesëmarrje në konferenca, kongrese dhe simpoziume ndërkombëtare dhe tarifat për dorëshkrimet që do të botohen në revista me faktor ndikimi, dhe që buxheti për projektet kërkimore të vogla nuk është i mjaftueshëm. **[Kapitulli I, Standardi II.4]**

#### Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- Universiteti duhet të fokusohet te përditësimi i plotë i faqes së internetit, ku të ofrojë informacion për të gjithë anëtarët aktualë dhe të mundshëm të universitetit. **[Kapitulli III, Standardi II.1]**
- Universiteti duhet të vijojë punën për zbatimin e strategjisë për rekrutimin e personelit akademik të kualifikuar dhe zhvillimin e mekanizmave nxitës për punësimin e tyre në universitet **[Kapitulli III, Standardi IV.1]**
- Duhet ndjekur një qasje e fokusuar te mënyra e rritjes së numrit të studentëve. **[Kapitulli I, Standardi I.1]**
- Treguesit kryesorë të performancës duhet të përfshihen në RVV. Duke filluar nga numri i studentëve të regjistruar rishtas, numri i përgjithshëm i studentëve, numri i çregjistrimeve dhe numri i diplomimeve. **[Kapitulli I, Standardi II.1]**
- UNIKO-ja duhet të rrisë aplikimet për projektet kërkimore të zakonshme nga thirrjet kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllim rritjen e numrit të projekteve kërkimore ndërkombëtare. **[Kapitulli II, Standardi I.1]**
- Numri i trajnimeve mbi mësimdhënien është i vogël, pavarësisht nevojës që pedagogët të njihen me metoda të reja mësimdhënieje. Qendra për Formimin e

Vazhduar duhet të planifikojë më shumë trajnime për personelin dhe trajnuesit e personelit për të kryer trajnim shtesë rreth metodave të reja të mësimdhënies dhe, në veçanti, për mësimdhënien *online*. **[Kapitulli I, Standardi II.4]**

- Kërkuesit e rinj dhe studentët duhet të mbështeten dhe të përfshihen më shumë në projekte kërkimore dhe në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare nga stafi i nivelit të lartë. **[Kapitulli I, Standardi II.6 dhe Kapitulli I, Standardi II.7]**
- Në të ardhmen e afërt, Universiteti duhet të organizojë workshop-e për personelin dhe studentët për ndërgjegjësimin rreth plagjiaturës. **[Kapitulli II, Standardi I.7]**
- Me qëllim fuqizimin e bashkëpunimit me të diplomuarit, Sektori i Komunikimit, Alumni dhe Karrierës duhet të organizojë më shpesh takime zyrtare. **[Kapitulli I, Standardi III.1]**
- Numri i vendeve në bibliotekën kryesore duhet të rritet, në mënyrë që studentët të kenë hapësirë të mjaftueshme për lexim **[Kapitulli I, Standardi III.6].**
- Numri i mobiliteteve për studentët në të ardhmen duhet të rritet, pasi studentëve do t'u bëhet e mundur të fitojnë përvoja të ndryshme në universitete evropiane **[Kapitulli I, Standardi III.8].**

### **Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimet aktualisht në proces si më poshtë:

- Puna e vazhdueshme për ofrimin e diplomave të dyfishta/përbashkëta me universitete evropiane (kryesisht greke), në kuadër të ndërkombëtarizimit. **[Kapitulli III, Standardi III.4]**
- Përdorimi i teknologjisë së informacionit në veprimtari të ndryshme është rritur gjatë vitit të fundit **[Kapitulli III, Standardi VII.1]**
- Përmirësimi dhe specializimi i mëtejshëm i laboratorëve, si laborator i Agroushqimor, do të rrisë pjesëmarrjen e studentëve në studime dhe kërkim, duke ndihmuar universitetin për ofrimin e shërbimeve ndaj institucioneve të tjera **[Kapitulli III, Standardi VII.2]**
- Diferencimi më i mirë i kurrikulave të programeve të studimit gjatë dy viteve të para të BA-së në Fakultetin e Ekonomisë, duke marrë në konsideratë dhe përvojën e universiteteve të tjera **[Kapitulli I, Standardi I.1]**
- Personeli akademik ka qenë dhe vijon të jetë i përfshirë në projekte të ndryshme Erasmus+ për ngritjen e kapaciteteve, dhe fokusi është te përmirësimi i proceseve, strukturave dhe instrumenteve për përmirësimin e kurrikulave. **[Kapitulli I, Standardi II.4]**
- Hapat që Universiteti ka ndërmarrë për rritjen e financimit për projekte kërkimore të vogla, që mund të realizohen nga personeli i departamenteve. **[Kapitulli II, Standardi I.1]**
- Mbështetja e Qendrës për Kërkim dhe Ekselencë për personelin akademik për aplikimin në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare. **[Kapitulli II, Standardi II.6]**
- Organizimi i Olimpiadës “Roke Shkencën”, me synim inkurajimin e nxënësve me rezultate të larta në shkolla të mesme për t'u bërë pjesë e kurrikulave të universitetit për tema të ndryshme **[Kapitulli I, Standardi III.5]**

## **Gjykime përmbledhëse për çdo Fushë Vlerësimi**

1. Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përbushur plotësisht.**
2. Standardet për Burimet janë **përbushur plotësisht.**
3. Standardet për Kurrikulën janë **përbushur plotësisht.**
4. Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur kryesisht**
5. Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përbushur plotësisht**



## Gjykim i përmbledhur

Vlerësuesit i rekomandojnë Bordit të Akreditimit se në Universitetin “Fan S. Noli” të Korçës, Standardet Shtetërore të Cilësisë janë **përbushur plotësisht.**

## Raport i detajuar

### Fusha e vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

- 1.1. Statuti përcakton misionin, objektivat, statusin juridik dhe menaxhimin organizativ të Universitetit **[A1.1.2]**. Ai mbulon edhe procedurat zgjedhore, organet vendimmarrëse, nivelet e autoritetit, sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, regjistrimin dhe diplomimin e studentëve, të drejtat dhe përgjegjësitë e personelit dhe studentëve, veprimtarinë kërkimore dhe çështjet financiare. Të kuptuarit e pjesëve përkatëse të Statutit u konfirmua gjatë takimeve me personelin e Universitetit **[BM2, BM5, BM9, BM10]**. Statuti i ri (i përditësuar) është hartuar dhe u miratua nga Ministria përgjegjëse për arsimin në janar të 2022-shit **[A1.1.2]**, duke u përcaktuar si i përputhshëm me Ligjin për Arsimin e lartë në Shqipëri. Rregullorja e veprimtarisë akademike dhe kërkimore shkencore e Universitetit, bashkërisht me Statutin, përbëjnë bazën për të gjitha proceset e tjera operationale të Universitetit **[A1.1.2, A1.2]**, si Plani i Zhvillimit dhe Termat e referencës së komiteteve **[A1.3.1]**. **Kapitulli III, Standardi I.1.**
- 1.2. Struktura organizative **[A1.1.2, A2.1]** e Universitetit është në përputhje me statutin, dhe kuptohet nga personeli që takoi Grupin e Vlerësimit të Jashtëm. Pjesët kryesore përbërëse të strukturës janë Bordi i Administrimit, Rektorati, Senati Akademik, Këshilli i Etikës, Bordi Editorial dhe Bordi Këshillimor. Rregulloret që drejtojnë autoritetin e tyre janë të përcaktuara qartë **[A1.24, A1.11, A1.20, BM5, BM9, BM10, BM11]**. Rektorati përcakton buxhetin e propozuar të vitit **[A56]**, bazuar tek informacioni/vërejtjet nga departamentet dhe fakultetet **[BM1, BM10]**. Më pas, buxheti i kalon Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit për miratim **[C7]**. Që prej vitit 2016, Bordi i Administrimit monitoron dhe kontrollon menaxhimin administrativ, financiar, ekonomik dhe të aseteve të Universitetit, në përputhje me Statutin **[A1.1.2]**. Këshilli i Etikës ka rregullore të përcaktuara qartë, dhe merr vendime në lidhje me çdo shkelje, duke raportuar te Rektori **[A1.20, A20.1]**. Universiteti përbëhet nga katër fakultete: Fakulteti i Bujqësisë, Fakulteti i Ekonomisë, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, si dhe Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane **[A1.1.2, A2.1]**. Këto fakultete janë të ndara në 15 departamente individuale. Fakultetet menaxhohen nga Dekanatet, të drejtuara nga Dekani, funksioni kryesor i të cilit është të kontribuojë në planin strategjik të Universitetit dhe të koordinojë funksionet akademike dhe kërkimore të departamenteve të fakulteteve **[A1.21, A2.3, BM10]**. **Kapitulli III, Standardi I.2**
- 1.3. Përgjegjësit e Departamenteve menaxhojnë programet e studimit dhe koordinojnë mësimdhënien, mësimnxënien dhe veprimtarinë kërkimore të departamentit, duke raportuar te Dekani i Fakultetit, i cili koordinon veprimtaritë e departamenteve **[A1.4, A1.7, A1.10]**. Anëtarët e Senatit Akademik, anëtarët e Bordit të Administrimit, Rektori, Dekanët e fakulteteve, dhe Përgjegjësit e departamenteve *zgjidhen të gjithë me votim të fshehtë* nga personeli akademik **[A1.1.2]**. **Kapitulli III, Standardi I.2**
- 1.4. Komitetet e Universitetit mblidhen rregullisht sipas rregulloreve dhe pikat për diskutim qarkullohen paraprakisht. Gjatë takimeve me personelin, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi **[BM5, BM9, BM10]** se ata ndihen të përfshirë në vendimet e Universitetit dhe se merren parasysh në çështjet që kanë rëndësi për ata dhe për Universitetin. Personeli është mbështetës dhe përfshihet në debate në Universitet. Vendimet e marra nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit kthehen në dekrete, që ruhen në

bazën e të dhënave nga Rektorati **[BM2]. Kapitulli III, Standardi I.3; Kapitulli III, Standardi II.3**

- 1.5. Siç u theksua më lart, Universiteti funksionon brenda kufijve të autonomisë së parashikuar në Statut dhe në Ligjin për Arsimin e lartë në Shqipëri. Ai përmban struktura për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e brendshëm të proceseve të tij. Në këtë drejtim, Universiteti ka një Njësi për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë **[A1.1.2, A2.20]**, që monitoron proceset e brendshme, ndjekur nga hartimi i raportit të vetëvlerësimit (vlerësimit të brendshëm) **[A2.5]**. Krahas kësaj, së fundmi, Universiteti ka ndërmarrë procesin e vlerësimit të jashtëm në kuadër të akreditimit për herë të parë të programeve të studimit, që është një element i rëndësishëm për rritjen e cilësisë dhe besueshmërisë së arsimit të ofruar nga Universiteti. **Kapitulli III, Standardi I.4**
- 1.6. Plani Strategjik i Zhvillimit (2016-2020), **[A1.3.1]** përditësuar së fundmi me Planin Strategjik të Zhvillimit (2022-2027), **[A1.3.2]** përcakton planet për zhvillimin e Universitetit në kontekstin e qarkut të Korçës. Në Universitet janë mbajtur konsultime lidhur me planin **[BM2, BM5, BM10]**, i cili ka mbështetjen e plotë të punëdhënësve kryesorë në qark **[BM6]**. Planet përputhen me Misionin dhe Vizionin Strategjik të Universitetit **[A1.1.2]** dhe me nevojat e punësimit të qarkut **[BM6]**. **Kapitulli III, Standardi I.5**
- 1.7. Çdo departament i Universitetit harton një raport vjetor mbi veprimtarinë përkatëse, **[A2.4, A2.5]** që përfshihet në Raportin e Fakultetit dhe, në fund, në Raportin e Universitetit. Pas miratimit nga Senati dhe Bordi i Administrimit, ky raport i dorëzohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit **[A1.15]**. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë harton një plan veprimi për përmirësim **[BM9]**, bazuar te gjetjet e saj. **Kapitulli III, Standardi I.6**
- 1.8. Strukturat e Universitetit, të referuara më sipër, janë të përshtatshme për përmbushjen e misionit dhe qëllimit të tij. Universiteti ka një strukturë të mirorganizuar në fakultete dhe departamente, dhe 57 programe studimi gjithsej, ku 7 prej të cilëve janë programe profesionale, 25 programe të ciklit të parë, 24 programe të ciklit të dytë dhe 1 program doktore, ku japin mësim 154 anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë **[A2.1, RVV f.8]**. Faqja e internetit e Universitetit është riaktivizuar së fundmi dhe institucioni po bën përpjekje për ta përditësuar rregullisht, qoftë në shqip, po ashtu dhe në anglisht, me informacione rreth Universitetit dhe programeve të studimit **[<http://www.unkorce.edu.al/en/>]**. *Gjithsesi, në periudhën e vizitës dhe në kohën e hartimit të këtij raporti, ajo vazhdonte të shfaqte probleme. Disa nga seksionet e rëndësishme, si 'orari mësimor,' Erasmus+ 'Maturantët' etj., janë ende jofunksionale* **Kapitulli III, Standardi II.1**
- 1.9. Propozimet për programe të reja kanë ardhur si rezultat i studimit të tregut. Për shembull, Masteri Profesional në Marketing Digjital, i hapur në vitin 2021, dhe programet profesionale dyvjeçare, përkatësisht në Shërbim Social dhe Mbështetës Zyre për Komunikim, Bibliotekë dhe Arkiv, **[BM2]** janë bazuar te studimi i tregut. Për Grupin e Vlerësimit të Jashtëm ishte e qartë se punëdhënësit publikë dhe privatë në qarkun e Korçës ishin konsultuar, dhe se i mbështesnin zhvillimet e reja të programeve nga Universiteti **[A2.37, BM6]**. Universiteti ka një Qendër Karriere aktive, që komunikon me Zyrën Rajonale të Punësimit për t'i informuar studentët rreth mundësive të punësimit **[BM6, BM9]**. **Kapitulli III, Standardi III.1**

- 1.10. Universiteti ndjek një strategji të hapur bashkëpunimi dhe partneriteti në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar, sikurse u pa nga dokumentacioni dhe **[A3.22, A3.31]** diskutimet me personelin **[BM2, BM5, BM8, BM10]**. Gama e bashkëpunimeve përfshin ato për kërkime, mobilitete dhe praktika profesionale **[A1.23, A2.18, A3.13]**. Gjithashtu, Universiteti promovon regjistrimin e studentëve të huaj në programet e tij dhe përfshirjen e personelit akademik të huaj në mësimdhënie, në përputhje me Statutin **[A19]**, megjithëse ende nuk është praktikuar. Universiteti planifikon të rrisë numrin e programeve të ofruara në gjuhën angleze për të lehtësuar këtë objektiv **[BM2]**. *Pavarësisht këtyre planeve të dobishme, është e qartë se Universiteti ka normë të ulët ndërkombëtarizimi, sikurse shihet nga numri i shkëmbimeve Erasmus+, në veçanti. Kapitulli III, Standardi III.2; Kapitulli III, Standardi III.3*
- 1.11. Universiteti ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ndjek disa praktika në këtë drejtim **[A3.22, A3.31]**. Nisur nga nxitja e fundit qeveritare për ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë, institucioni ndodhet në fazat përfundimtare të finalizimit të një marrëveshjeje me disa Universitete në Greqi për diploma të dyfishta, gjë të cilën Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e gjykon si një **veprim në proces [BM2]**. Në këtë kuadër, Universiteti ndjek dhe një *Strategji* më të gjerë *Ndërkombëtarizimi 2019-2021*, që është treguese e rëndësisë që Universiteti i kushton ndërkombëtarizimit. Përgjithësisht, marrëveshjet e bashkëpunimit ndërkombëtar me ndikim më të lartë janë ato që u mundësojnë mobilitet ndërkombëtar studentëve dhe personelit, si Erasmus+ **[A2.18]**. Nëpërmjet dokumentacionit, po ashtu dhe gjatë takimeve të vizitës së vlerësimit, u informuam rreth rëndësisë dhe ndikimit të marrëveshjeve të ndryshme të bashkëpunimit ndërkombëtar në zbatim për Universitetin. **[BM2, BM8, BM10]**. *Kapitulli III, Standardi III.4*

## Gjetje

### Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

### Pikat e dobëta

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë pikë të dobët.

### Rekomandimet

- Universiteti duhet të fokusohet te përditësimi i plotë i faqes së internetit, ku të ofrojë informacion për të gjithë anëtarët aktualë dhe të mundshëm të universitetit. **Kapitulli III, Standardi II.1**

### Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimet aktualisht në proces si më poshtë:

- Puna e vazhdueshme për ofrimin e diplomave të dyfishta/përbashkëta me universitete evropiane (kryesisht greke), në kuadër të ndërkombëtarizimit. **Kapitulli III, Standardi III.4**

## **Gjykimi**

**Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur plotësisht.**

## Fusha e vlerësimit 2: Burimet

2.1 Universiteti i Korçës “Fan S. Noli” (UNIKO) është një institucion i arsimit të lartë, që funksionon në përputhje me legjislacionin shqiptar për arsimin e lartë, si dhe me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Struktura organizative përputhet me Ligjin nr. 80/2015 për arsimin e lartë **[A1.1. Neni 5]**, Struktura institucionale, organizimi dhe organigrama përfshihen në dokumentet rregullatore kryesore të institucionit, si Statuti, rregullorja e UNIKO-s dhe një sërë aktesh të tjera rrjedhëse (Statuti, Rregullorja). Kërkesat për burimet njerëzore i propozohen Rektoratit nga njësitë bazë dhe miratohen nga Bordi i Administrimit. **[A1.1.1]**. Organigrama **[A2.1]** pasqyron strukturën funksionale të UNIKO-s dhe është publikuar në faqen e internetit [\[www.uniko.edu.al\]](http://www.uniko.edu.al), po ashtu dhe në një sërë materialesh promociionale **[A1.1f]**. Statuti dhe dokumentet shtesë mundësojnë një përmbledhje të qartë të strukturës organizative, që përfshin fakultetet, departamentet, qendrat kërkimore dhe strukturat e tjera të menaxhimit **[A1.1. Neni 40, A2.1]**. Sipas organigramës **[A2.1]**, njësitë e tjera përbërëse të UNIKO-s përfshijnë pjesën e personelit administrativ që ushtron funksionet përkatëse (qendrat kërkimore, laboratorët, etj.). UNIKO-ja ka një statut, që përcakton formimin e komiteteve të përhershme, që ndihmojnë me organizimin e punës së Universitetit. Përgjegjësitë individuale, funksionet kryesore, detyrat, kompetencat dhe e gjithë veprimtaria e tyre akademike, në secilën pjesë të strukturës së menaxhimit, përcaktohen qartë në Statut dhe në Rregullore **[A2.1]**. Rolet e personelit akademik dhe administrativ janë paraqitur në detaj brenda strukturës së përgjithshme të miratuar. **[A1.1. Neni 10, A 2.1]**. **Kapitulli III, Standardi IV.1**

2.2 Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi se rekrutimi në njësitë akademike mbështetet nga analiza e nevojave e posaçme për fakultetin, departamentin, programin e studimit dhe kurrikulën, pavarësisht nëse roli është me kohë të plotë apo të pjesshme **[A3.14.1, A3.14.2 BM2, BM9]**. Vendet vakante publikohen në faqen e internetit të Universitetit nëpërmjet programit të transparencës dhe në Buletinin e Prokurimit Publik, në përputhje me rregulloren e punësimit. **[A1.2 Neni 32]**. Proceset e rekrutimit për personelin mësimdhënës, shkencor dhe administrativ ndjekin të njëjtin proces të përcaktuar në Statut dhe në Rregullore, që respektojnë legjislacionin përkatës. **[A 1.1.2]**. Për vlerësimin e aplikimeve të kandidatëve ngrihet një komision, që kryen vlerësim në bazë të meritave individuale, dhe kontrata e punësimit nënshkruhet nga Rektori. **[A1.1.2 Nenet 38, 41, 42]**. Prioriteti i është dhënë rekrutimit të personelit akademik me kohë të plotë të kualifikuar në universitete ndërkombëtare të mirënjohura, megjithëse, në raste specifike, si në rastin e infermierëve dhe mamive, për shkak të nevojës për praktikë të gjerë, ky kriter nuk përbën synim të lehtë **[RVV f.20]**. Në përputhje me natyrën specifike të institucionit dhe pozicionin gjeografik, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi se UNIKO-ja ka ndërmarrë veprime të posaçme për përmirësimin e rekrutimit të personelit akademik me kualifikim të lartë, që përfshijnë kriteret e posaçme të vlerësimit të aplikantëve, të cilët kanë diploma akademike dhe specializime jashtë vendit **[BM5, BM10]**. Në politikat, procedurat dhe veprimtaritë e tij, UNIKO-ja ofron informacion gjithëpërfshirës për personelin dhe studentët e tij. Faqja e internetit është një burim i dobishëm informacioni publik, që plotësohet nga informacione shtesë të mundësuar nëpërmjet portalit të mbrojtur me fjalëkalim [\[www.uniko.edu.al\]](http://www.uniko.edu.al). Gjithashtu, UNIKO-ja krijon një sërë fletushkash dhe broshurash informuese, si dhe boton libra. **[RVV f.21]**. Këto elemente u verifikuan dhe konfirmuan nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjatë takimeve të mbajtura në veçanti me personelin,

studentët dhe personat përgjegjës për sistemin e informacionit dhe TI-në në UNIKO.

**Kapitulli III, Standardi IV.2;**

- 2.3 UNIKO-ja ndjek një politikë vlerësimi periodik ndaj personelit akademik dhe atij administrativ. Vlerësimi i personelit akademik përfshin pyetësorin për cilësinë e programeve akademike, të kryer nga NJSBC-ja dhe Këshilli Studentor [A3.28], dhe për performancën akademike të pedagogëve në përfundim të modulit [A2.25]. Vlerësimi i personelit administrativ kryhet nëpërmjet formularit të posaçëm të vlerësimit të personelit administrativ [A3.6] duke u finalizuar me Pyetësorin e Vlerësimit të Performancës, i hartuar në përputhje me Ligjin e Menaxhimit dhe kontrollit financiar, ku pasqyrohet performanca e secilit anëtar të personelit administrativ, në përputhje me përshkrimin e punës dhe kërkesat profesionale të parashikuara në rregulloret e Rektoratit dhe departamenteve përkatëse [A3.35]. Personelit akademik i kryhet edhe një vlerësim më i gjerë performance përpara rinovimit të kontratës së tyre në nivel departamenti/fakulteti nga përgjegjësit përkatës të departamenteve dhe Dekani, bazuar te modeli i vlerësimit i përgatitur duke u mbështetur te Doracaku i Sigurimit të Cilësisë [A1.16]. Për trajtimin e nevojave të identifikuara që vijnë nga vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe performancës kërkimore, UNIKO-ja ka përcaktuar objektiva strategjike për zhvillimin e personelit në disa dokumente dhe rregullore strategjike, dhe ka ndjekur një politikë formimi të vazhdueshëm ndaj personelit (deri në 90%), në përputhje me këta objektiva [RVV f.21, BM2, BM5, BM10]. Personeli nxitet të marrë pjesë në programe mobiliteti me IAL të huaja [A2.18] duke shfrytëzuar plotësisht marrëveshjet e bashkëpunimit ndërkombëtar të nënshkruara nga UNIKO-ja [A3.31]. Personelit akademik i ofrohet mbështetje për pjesëmarrje në veprimtari formuese në institucione të tjera të ngjashme dhe ndërkombëtare. [RVV f.21, A 1.39]. UNIKO-ja ka ngritur një sistem për mësimdhënien online dhe menaxhimin, të quajtur Pitagora [BM9]. Për këtë qëllim, janë shpërndarë manuale dhe udhëzues, si dhe janë zhvilluar disa trajnime në lidhje me teknikat e mësimdhënies online për përmirësimin e qasjes së pedagogëve [BM5, BM9]. Vetëm në vitin 2022, 19 anëtarë të personelit mësimor kanë marrë pjesë në këto programe mobiliteti ndërkombëtar. UNIKO-ja e nxit personelin akademik të zhvillojë kualifikimet përkatëse, të marrë pjesë në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe nxit personelin akademik të nivelit të lartë të marrë përsipër një ngarkesë pune mësimore më të madhe për t'u bërë të mundur kolegëve më të rinj të fokusohen te kërkimi akademik dhe të botojnë punimet e tyre në revista [RVV f.21, BM5, BM10]. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi se UNIKO-ja është ende në kërkim të mekanizmave nxitës të përshtatshëm, me qëllim nxitjen e përmirësimit profesional të personelit akademik, megjithëse mbështetja financiare e nevojshme për rritjen e performancës kërkimore është ende e pamjaftueshme
- Kapitulli III, Standardi IV.3.**

- 2.4 Sa i përket ndjekjes së një politike zhvillimi social, UNIKO-ja është angazhuar për zbatimin e politikave të integritit të personelit akademik dhe administrativ për të mbështetur pjesëmarrjen në veprimtari zhvillimi rajonal [BM6]. Në ambientet e UNIKO-s janë organizuar dhe disa aktivitete të ndryshme me palët e interesit të zhvillimit vendor [RVV f.24, BM6]. UNIKO-ja është angazhuar që të luajë një rol kyç gjithnjë e më të madh në zhvillimin socio-ekonomik të rajonit, duke ndërmarrë nisma të posaçme, si ofrimi i laboratorëve të nevojshëm për partnerët industrialë ose zhvillimi apo rishikimi i programeve akademike në kuadër të nevojave të partnerëve vendorë [BM6, BM10]. Personeli akademik në UNIKO e mbështet qëndrimin e përshkruar në raportin e vetëvlerësimit sa i përket angazhimit të tyre në aktivitete të ndryshme, si

workshop-e, aktivitete në terren, konkurse për shkollat e mesme, dhe organizime sociale krahas mësimdhënies. **[RVV f.22, BM5, BM10]**. Gjatë periudhës përpara fillimit të pandemisë së COVID-19-s, UNIKO-ja organizoi disa aktivitete me natyrë sociale, kulturore, sportive, etj., falë mbështetjes së ofruar nga partneritetet e krijuara në kuadër të veprimtarisë akademike **[BM3, BM4]**. UNIKO-ja mbështet integrimin e personelit akademik dhe administrativ në jetën shoqërore dhe i inkurajon ata që të përfshihen në aktivitete jashtëshkollore të ndryshme, në aktivitete sociale, dhe në promovimet e librave të organizuara në bashkëpunim me institucionet arsimore vendase ose me institucionet e tjera partnere në rrethin e Korçës dhe më gjerë **[BM5, BM6, BM10] (Kapitulli III, Standardi IV.2)**. Të gjithë punonjësit e UNIKO-s kanë sigurime shëndetësore, pasi paguajnë “Kontributet e sigurimit të detyruar shëndetësor” **[VKM 568, 2021]**, të cilat paguhen në përputhje me legjislacionin përkatës. **Kapitulli III, Standardi IV.4.**

- 2.5 UNIKO-ja ka përcaktuar qartë në aktet përkatëse lidhur me politikat e menaxhimit të personelit, për personelin akademik dhe atë joakademik, duke nisur me identifikimin e nevojave në lidhje me burimet njerëzore dhe vlerësimin e cilësisë së performancës së personelit aktual **[A 3.14.1, A 3.14.2, BM9, BM10]**. Veprimtaritë dhe procedurat lidhur me personelin përcaktohen konkretisht në legjislacionin në fuqi dhe në aktet e brendshme të UNIKO-s, si Statuti dhe rregullorja e brendshme. **[A 1.1.2 Nenet 11, 38, 41, 42]; [A 1.2 Neni 33]**. Kodi i Punës është baza për rekrutimin, marrëveshjet e punësimit dhe raportet e punësimit, si dhe për kërkesat për angazhimin akademik, kurrikulat dhe/ose funksionin në UNIKO dhe parashikimet e posaçme në kontratën specifike të punësimit të personelit, duke përfshirë përshkrimet e punës **[A 1.26]**. Kontratat përcaktojnë qartë rolin, veprimtaritë dhe ngarkesën e punës së personelit **[A 3.10]**. Rregullorja përmban një kapitull të veçantë për menaxhimin e marrëdhënieve të personelit, që disiplinon dhe përcakton procedurat përkatëse të të gjithë procesit. **[A 1.2 Neni 33]**. Bazuar te parashikimet e kontratave individuale, vlerësimi i performancës dhe shpërblimi sipas kontributit të pritshëm dhe te rishikimi i kushteve kontraktuale, ekzistojnë kushte dhe procedura të qarta dhe transparente për marrjen e masave disiplinore dhe administrative ndaj shkeljeve **[A 1.2 Neni 35], [A 1.26]**. Dokumentacioni lidhur me burimet njerëzore dhe kontratat shoqëruese, si dhe procedura përkatëse, mbahen në Zyrën e Burimeve Njerëzore **[BM9]**. Në fillim të vitit akademik, personeli nënshkruan Marrëveshjen Vjetore të Ngarkesës së Punës, ku përcaktohet ngarkesa dhe përshkruhet menaxhimi i saj **[A 3.9, BM5]**. Bazuar te deklaratat e UNIKO-s **[RVV f.23]** dhe te takimet me personelin dhe studentët, GVJ-ja konstatoi se ka pasur raste të marrjes së masave ndaj personelit akademik për mospërmblidhjen e detyrimeve ose për shkeljen e rregullave të parashikuara në aktet e lartpërmendura **[BM5, BM9]**. Personeli akademik me përvojë dhe ekspertizë në vlerësimin e cilësisë është gjithashtu i përfshirë në detyrat administrative që synojnë përmirësimin e efikasitetit të menaxhimit, si dhe për promovimin e përmirësimit të kualifikimeve dhe përmirësimin e performancës **[A 2.1, BM 10]**. Njësitë Juridike dhe të Burimeve Njerëzore i nxisin njësitë të kryejnë vlerësim të performancës së personelit duke u mbështetur te modeli i përcaktuar në Doracakun e Cilësisë **[A 1.16, BM 9]**. Janë ndërmarrë veprime në kuadër të integritetit dhe përshtatjes së procedurës së vlerësimit në nivel departamenti, me fokus te rritja e gjithëpërfshirjes duke përfshirë në vlerësim kriteret specifike shtesë për pedagogët e angazhuar aktualisht **[A 3.7]**. **Kapitulli III, Standardi II.2**



- 2.6 UNIKO-ja ndjek kuadrin ligjor të Ministrisë së Financave, dhe parashikimet përkatëse në statut dhe në rregullore për të hartuar planin vjetor si bazë për buxhetimin e veprimtarisë së tij, ushtrimin e autonomisë financiare në përputhje me rregullat dhe standardet e programimit buxhetor dhe menaxhimin e financave publike **[A1.1.1 Neni 84]**. Megjithëse menaxhimi financiar dhe kontrolli buxhetor janë të centralizuar dhe njësitë akademike nuk gëzojnë autonomi financiare, janë bërë përpjekje për dhënien e incentivave ndaj departamenteve për arritjen e rezultateve më të mira sa i përket kërkimit akademik, numrit të studentëve ose projekteve/mobiliteteve ndërkombëtare **[BM5, BM10]**. *Kapitulli III, Standardi VI.1*
- 2.7 Drejtori i Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria e Financës përgatisin projektbuxhetin bazuar te nevojat financiare të propozuara nga departamentet, për të siguruar zbatimin e suksesshëm të veprimtarive akademike, kërkimore dhe menaxheriale **[A 1.8, BM9]**. Projektbuxheti i propozuar diskutohet në të gjitha strukturat përkatëse të departamenteve, fakulteteve, në Rektorat, dhe më pas miratohet nga Senati dhe Bordi i Administrimit **[A 2.2, A 1.8, A 2.1, C5]**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vërejtë se buxheti financiar i vitit 2022 është miratuar nga Bordi i Administrimit dhe u është dorëzuar institucioneve përgjegjëse për miratimin përfundimtar të zbatimit **[A 2.2.1]**. *Kapitulli III, Standardi VI.2*
- 2.8 Transparenca sigurohet falë diskutimit të çështjeve financiare në Senatin Akademik, që përfshin përfaqësues nga personeli dhe studentët **[BM4, BM9]**. Procesi i projektimit të buxhetit dhe sistemi i menaxhimit administrativ financiar është i strukturuar, efikas dhe i njohur për personelin dhe përfaqësuesit e studentëve falë mbledhjeve mujore në Rektorat dhe takimeve të hapura për sigurimin e transparencës, ndërsa zbatimi monitorohet nga Njësia e Menaxhimit Strategjik, e drejtuar nga Administratori i Universitetit **[A 1.8, BM4, BM10]**. Në përputhje me kërkesat statutores dhe aktet e tjera ligjore, UNIKO-ja i është nënshtruar kontrollit të jashtëm/brendshëm periodik. **[A1.1.1, A 1.1.2, RVV f.25]**. Informacioni financiar është i disponueshëm publikisht në faqen e internetit [\[www.unkorce.edu.al/programi-i-transparences-2\]](http://www.unkorce.edu.al/programi-i-transparences-2). UNIKO-ja është duke specializuar personelin për përdorimin e laboratorëve për analiza dhe përmirësimin e shëndetit financiar duke gjeneruar burime të tjera financiare, krahas tarifave studentore **[BM10]**. *Kapitulli III, Standardi VI.3.*
- 2.9 UNIKO-ja ka ngritur një sistem për mësimin *online* dhe një sistem digjital për sekretarinë dhe menaxhimin e bazës së të dhënave të studentëve, mbështetur te paketa Microsoft Teams<sup>1</sup> (Pitagora zëvendësoi Esse 3) **[A1.6.2, A2.31.1, BM9]**. UNIKO-ja përdor një sistem të integruar për menaxhimin e informacionit, që përfshin faqen publike të internetit dhe portalin me fjalëkalim, falë të cilit studentët dhe personeli mund të aksesojnë informacione konfidenciale dhe llogaritë e tyre institucionale personale **[A1.6.1, BM3, BM4, BM9]**. Faqja institucionale e internetit është mjeti kryesor i komunikimit dhe informimit, për shkak të zhvillimit dhe shpërndarjes së informacionit në nivel vertikal dhe horizontal [\[www.uniko.edu.al\]](http://www.uniko.edu.al). Faqja institucionale e internetit mundëson një vështrim të përgjithshëm gjithëpërfshirës, informacione strategjike dhe njoftime publike lidhur me nevojat akademike të Njësive Kryesore dhe Bazë, dhe u mundëson studentëve informacione rreth studimeve të tyre, aktiviteteve sociale ose rrjeteve të alumnit [\[www.unkorce.edu.al/guida-uniko/\]](http://www.unkorce.edu.al/guida-uniko/), **BM3, BM4, BM9]**.

<sup>1</sup> [www.unkorce.edu.al/guida-uniko/](http://www.unkorce.edu.al/guida-uniko/)

UNIKO-ja ka ndërmarrë përpjekje shtesë për t'u mundësuar studentëve informacionin e nevojshëm rreth programeve të studimit, mundësive të punësimit dhe, gjithashtu, njofton edhe publikun nëpërmjet mundësimit të aksesit të të gjitha dokumentet ligjore dhe të procesi i vendimmarrjes **[A1.6.1, BM9]**. Universiteti është i pranishëm edhe në Facebook **[BM3]**. Studentët shprehen se pedagogët përdorin një sërë mjedesh elektronike për t'u mundësuar burimet e nevojshme, që përfshijnë adresat personale të e-mail-it dhe paketat, si ajo e Microsoft Teams **[A1.6.1, BM4]**. UNIKO-ja ka ndërmarrë zhvillimin e infrastrukturës digjitale në mbështetje të të nxëniet të studentëve dhe zhvillimit profesional të personelit akademik.**[BM9]**. Me qëllim koordinimin e informacionit, UNIKO-ja përdor sistemin online Pitagora për studentët dhe personelin akademik. **[RVV f.27, A1.6.2, BM9]**. Në këtë mënyrë, shumica e veprimtarive institucionale janë të disponueshme në formë elektronike, duke përfshirë shërbimin e protokollimit dhe arkivimit, sistemet bibliotekare, ndërsa monitorët përdoren për udhëzimin e përditësuar të studentëve **[RVV f.27, BM9]**. Grupi konfirmoi përdorimin e teknologjisë nga ana e institucionit për ndarjen e informacioneve me studentët, por edhe me palët e tjera rajonale të interesit, si mundësitë e regjistrimit në UNIKO<sup>2</sup>. UNIKO-ja i ka centralizuar të gjitha këto shërbime dhe veprimtari në një sistem të vetëm menaxhimi për të gjithë institucionin. **[BM3, BM4, BM9] Kapitulli III, Standardi VII.1, Kapitulli III, Standardi VII.5**

- 2.10 Gjatë vizitës në ambient, GVJ-ja konstatoi se godinat janë të pajisura me lidhje të dedikuar interneti, që mbulon të gjitha ambientet në dispozicion të UNIKO-s me internet dhe Wi-Fi **[BM11]**. Të gjithë auditorët janë të pajisur me laptopa, videoprojektorë dhe internet, ku 20% kanë tabelë digjitale, dhe ndodhet edhe një sallë kompjuterike, ku studentët marrin informacione ose e përdorin për lundrim në internet, si dhe për akses online dhe për konsultimin e bibliotekës elektronike **(RVV f.27; A3.20.1, BM11)**. Në çdo fakultet ndodhen salla laboratorike elektronike për teknologjinë e informacionit, të pajisura me kompjutera dhe laptopa, me rreth 25 kompjutera për sallë **[A3.20, BM11]**. Studentët pohuan përdorimin efektiv të tyre gjatë takimeve (megjithëse, gjatë periudhës së pandemisë, mësimi u zhvillua kryesisht online dhe jo fizikisht) **[A2.26, BM3, BM4]**. UNIKO-ja ofron një sërë laboratorësh të pajisur me pajisjet bazë. **[A3.20, BM11]**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konfirmoi ngritjen e infrastrukturës laboratorike të dedikuar në Fakultetin e Bujqësisë dhe të Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane, që bën të mundur rritjen e performancës didaktike të studentëve dhe ofrimin e shërbimeve ndaj institucioneve të tjera, ndërsa ngritja e një laboratorit modern për mësimdhënie hibride përbën një praktikë të mirë **[BM11] Kapitulli III, Standardi VII.2**
- 2.11 UNIKO-ja mban një regjistër të pasurive përkatëse, që shtrihet te të gjitha Godinat Shtetërore nën administrimin e MASR-së, ndërsa, falë projekteve ndërkombëtare, është realizuar modernizimi dhe pajisja e godinave ekzistuese për t'u shërbyer më mirë nevojave të studentëve dhe personelit për programe akademike dhe kërkimore **[RVV f.28, BM9, BM11]**. Është zbatuar dhe një Master Plan për: zgjerimin (godina të reja) dhe rikonstruktimin e godinave ekzistuese; përmirësimin e aspekteve lidhur me sigurinë; dhe pajisjen e godinave me objektet e nevojshme për garantimin e një procesi mësimor të rregullt **[A3.36, BM11]**. UNIKO-ja ka nënshkruar dokumentacionin e kërkuar sa i përket sigurimit të godinave **[A1.1g]**. Sipërfaqja e ambienteve është në

---

<sup>2</sup> [www.unkorce.edu.al/kendi-i-maturanteve/](http://www.unkorce.edu.al/kendi-i-maturanteve/)

proporcion me numrin e studentëve, ndërsa investimi vjetor siguron mirëmbajtjen e infrastrukturës në standardin e kërkuar, bazuar te dokumentacioni i posaçëm [RVV f.28, A 1.7, BM10, BM11]. *Kapitulli III , Standardi VII.3*

- 2.12 UNIKO-ja ka një trashëgimi të gjatë akademike dhe kulturore, pasi kryen arkivimin e botimeve të personelit akademik dhe tezave të diplomave të krijuara nga studentët në bibliotekë, ndërsa i kushtohet vëmendje e veçantë përfaqësimit të aseteve universitare [A1.1f, BM11]. Universiteti ka flamurin dhe stemën e tij, ndërsa kryen edhe publikime për përvjetorë të caktuar, dhe personeli në pension ftohet të marrë pjesë në aktivitete lidhur me veprimtaritë kulturore dhe historike rajonale dhe kombëtare [A 1.1 f]. UNIKO-ja paraqet një gamë të plotë botimesh akademike nën “Buletinin Shkencor” periodik [RVV f.29] *Kapitulli III, Standardi VII.4*
- 2.13 Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson se, përgjithësisht, cilësia e ambienteve mësimore dhe aksesit për individët me aftësi të kufizuara i përmbushin kërkesat statutores [BM11]. Janë lidhur marrëveshje me organizata të tjera për mundësimin e veprimtarisë sportive, si Shoqata Sportive “Fan Noli” dhe Pallati i Sportit i Bashkisë, që kanë bërë të mundur ngritjen e dy ekipeve sportive konkurruese studentësh: ekipin e volejbollit të femrave dhe ekipin e futbollit të meshkujve, të cilat kanë fituar konkurse kombëtare dhe ndërkombëtare [A 1.3.2, BM4, BM11]. Për t’u mundësuar një mjedis pune të vërtetë studentëve të infermierisë, përdoren ambiente spitalore [BM3; BM9]. Përgjithësisht, klasat dhe laboratorët përmbushin kërkesat [A 1.15], biblioteka është e digjitalizuar, ndërsa veprimtaritë e menaxhimit të kryera nga Universiteti përfshijnë dhe testimet periodike të kushteve të higjienës dhe të sistemit qendror të ngrohjes [A 3.20.2]. *Kapitulli III, Standardi V.1*
- 2.14 Sektori Juridik dhe i Protokoll Arkivit arkivon dhe mban dokumentacionin sipas rregullave dhe parashikimeve të përcaktuara në rregulloren e departamenteve përkatëse [A 1.4]. Në Universitet gjenden sisteme menaxhimi efektive dhe të koordinuara për të siguruar kujdesin dhe ruajtjen e të gjithë dokumentacionit dhe informacionit, që përfshijnë dhe të dhënat e studentëve të mbajtura nga Sekretaritet Mësimore dhe dokumentacionin profesional përkatës të personelit [RVV f.29, BM9]. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi se pajisjet e ruajtjes elektronike dhe arkivimit në biblioteka përmbushin pritshmëritë ligjore. [BM9, BM11]. *Kapitulli III, Standardi V.2*
- 2.15 UNIKO-ja bashkëpunon me palë të treta të jashtme për përmirësimin e mësimdhënies, veprimtarive të kërkimit shkencor dhe shërbimeve me interes të përbashkët [BM1, BM6, BM10]. Laboratorët në njësitë akademike po punojnë për ofrimin e shërbimeve ndaj institucioneve të jashtme dhe partnerëve të rëndësishëm në tregun e punës nëpërmjet marrëveshjeve që respektojnë rregulloret institucionale. [A 3.20.2, BM6, BM9]. UNIKO-ja është duke specializuar personel akademik për rritjen e efikasitetit të shërbimeve të infrastrukturës laboratorike, si në rastin e laboratorit Agroushqimor<sup>3</sup>, që mund të vendoset edhe në dispozicion të palëve të treta në rajon [BM6]. Personeli akademik dhe studentët kanë akses edhe tek arkivat nga partnerët ose Akademia e Shkencave, Biblioteka Kombëtare, JStore etj. [BM3, BM4, BM5, BM9]. *Kapitulli III , Standardi VII.6*

---

<sup>3</sup> UNIKO-ja ka aplikuar për të marrë certifikatën ISO për laboratorin Agroushqimor.

## Gjetje

### Praktika e mirë

- Ngritja e laboratorit për mësimdhënie hibride është praktikë e mirë (**Kapitulli III, Standardi VII.2**)

### Pika të dobëta

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë pikë të dobët.

### Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- Universiteti duhet të vijojë punën për zbatimin e strategjisë për rekrutimin e personelit akademik të kualifikuar dhe zhvillimin e mekanizmave nxitës për punësimin e tyre në universitet (**Kapitulli III, Standardi IV.1**)

### Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi veprimin e mëposhtëm të ndërmarrë:

- Përdorimi i teknologjisë së informacionit në veprimtari të ndryshme është rritur gjatë vitit të fundit (**Kapitulli III, Standardi VII.1**)
- Përmirësimi dhe specializimi i mëtejshëm i laboratorëve, si laboratorit Agroushqimor, do të rrisë pjesëmarrjen e studentëve në studime dhe kërkim, duke ndihmuar universitetin për ofrimin e shërbimeve ndaj institucioneve të tjera (**Kapitulli III, Standardi VII.2**)

## Gjykimi

**Standardet për Burimet janë përmbushur plotësisht.**

## Fusha e vlerësimit 3: Kurrikula

3.1 Programet aktuale të studimit synojnë harmonizimin e kulturës tradicionale dhe përvojës së UNIKO-s për arritjen e qëllimit për t'u shndërruar në një palë interesi kyç për zhvillimin rajonal dhe përmbushjen e nevojave të tregut në ndryshim të shpejtë **[A1.2 Neni 56, BM10]**. Prandaj, programet e studimit në UNIKO janë krijuar në kuadër të misionit dhe objektivit të tij për përgatitjen e specialistëve të rinj për mbulimin e nevojave të tregut të punës për mësues, agronomë, ekonomistë, ekspertë TI-je, infermierë, por edhe shkencëtarë të shkencave të natyrës **[A3.3, BM5]**. E njëjta qasje për mbulimin e nevojave të tregut të punës dhe për të marrë në konsideratë mundësitë për mbështetjen e zhvillimit rajonal vlen edhe për hapjen e programeve të reja të studimit **[A3.36, BM10]**. Ekipi akademik po punon për diversifikimin e mëtejshëm të ofertës akademike, që përfshin gjashtë programet e Bachelorit në Fakultetin e Ekonomisë, për trajtimin më të mirë të nevojave specifike të tregut të punës **[BM5, BM10]**. Për informimin e nxënësve të shkollave të mesme rreth mundësive të studimit, UNIKO-ja organizon rregullisht fushata të shpeshta për “ditët e informimit të të diplomuarve nga shkollat e mesme” ose “Olimpiadat e matematikës”, me mbështetjen e Drejtorisë Arsimore Rajonale dhe nën koordinimin e Qendrës së Karrierës dhe Alumni ose palëve të tjera vendore të interesit **[A3.32, BM9]**. Fushata e zhvilluar nga personeli akademik i UNIKO-s mbulon territorin e Bashkisë Korçë dhe bashkive të tjera fqinje, si ajo e Pogradecit, dhe finalizohet me panairët e punës së UNIKO-s dhe aktivitete të tjera të ditëve të hapura<sup>4</sup>. Një shembull i mirë është përfshirja e mësuesve të shkollave të mesme në veprimtaritë e të nxënësve gjatë gjithë jetës në Qendrën e Formimit të Vazhduar, për të rritur mundësitë e bashkëpunimit ndërmjet arsimit të mesëm dhe atij të lartë **[A3.26, BM10]**. Kriteret e pranimit përcaktohen në Statutin dhe Rregulloren e UNIKO-s, si dhe në rregulloret përkatëse të programeve të studimit **[A1.1.1, A 1.2]**. Si një IAL publike, UNIKO-ja i publikon programet e studimit në faqen e internetit [\[https://moodle.unkorce.rash.al/\]](https://moodle.unkorce.rash.al/), ndërsa çdo fakultet/departament mundëson informacion në faqen e posaçme të internetit rreth programit të studimit, si syllabusin, kurrikulat dhe dokumentacionin e programeve **[A2.7, A 2.8, A 2.9]**. UNIKO-ja ofron programe studimi në të tri ciklet e studimit: (23) programe Bachelor; (20) Mastera Profesionale (13 nga 60 kredite ECTS dhe 7 nga 120 kredite ECTS); (3) Mastera Shkencorë; (1) Program doktorature; (7) programe profesionale 2-vjeçare, duke pasur gjithsej 60 programe studimi (6 prej të cilave joaktive) **[A1.3.2, BM5]**. Megjithëse programet e studimit përmirësohen çdo vit deri në 20%, ekzistojnë programe të caktuara, që janë përmirësuar rrënjësisht ose që janë krijuar për të pasqyruar nevojat e tregut të punës, si Informatika e Biznesit dhe Bujqësia **[A3.37, BM10]**. Për shkak të numrit në rritje të programeve të reja, numri i programeve që duhet të akreditohen ose që janë në proces akreditimi është relativisht i madh, si vijon: a) Program studimi profesional (56% në proces akreditimi dhe 30% pa akredituar); b) Program Masteri Profesional (120 kredite ECTS) 100% i akredituar; c) Master Profesional (60 kredite ECTS): 21% në proces akreditimi; d) Programe Bachelor: 23% në proces akreditimi dhe 46% pa akredituar; f) Program doktorature, 100% i akredituar **[A1.3.2]**. Për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të të nxënësve, organet kolegjiale të UNIKO-s respektojnë rregulloret e secilit program studimi dhe mbështeten te veprimtaria e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC) **[A1.16, A1.2, Neni 16, BM5, BM10]**. UNIKO-ja përcakton rregullat dhe procedurat për vlerësimin e

<sup>4</sup> <https://www.facebook.com/unkorce/posts/1949161445108566>

programeve të studimit në vazhdimësi nëpërmjet provimeve përfundimtare dhe punimit të diplomës **[A1.1, Neni 46]**. Fakultetet dhe departamentet e UNIKO-s propozojnë kuota, të cilat miratohen nga Senati i UNIKO-s dhe lidhen me pranimin e studentëve të rinj sipas programeve të studimit **[A1.2, A2.7, A2.8, A2.9, BM10]**. **Kapitulli I, Standardi I.1**

3.2 Përtej misionit kryesor të formimit të ekspertëve dhe kërkuesve të ardhshëm të aftë të mbulojnë nevojat aktuale të tregut të punës, njësitë dhe personeli akademik i UNIKO-s fokusohen te përgjegjësia e zhvillimit dhe hapjes së programeve të studimit, që kanë për synim të nxënit e vazhdueshëm gjatë gjithë jetës **[RVV f.35, BM10]**. Modulet formuese, në kuadër të Të Nxënit Gjatë Gjithë Jetës (TNGJJ), janë përgatitur për të mbuluar nevojat e reja të tregut, për shembull, modulet formuese për sipërmarrjen, ose për arsimin bazë, ndërkohë që po zhvillohen dhe module të tjera, si ato në fushën e bujqësisë dhe kujdesit shëndetësor, falë bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë në kuadër të projekteve Erasmus+<sup>5</sup> **[BM10]**. Janë bashkuar dy Qendra të Ekselencës për Formim pranë Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë dhe Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane, për ngritjen e Qendrës për Formimin e Vazhduar me fokus te përgatitja e moduleve formuese dhe kryerja e trajnimit të mësuesve në arsimin parauniversitar lidhur me arsimin gjithëpërfshirës dhe zhvillimin e kompetencave në sistemin e AFP-së në Shqipëri<sup>6</sup>. Programet e Të nxënit gjatë gjithë jetës (TNGJJ) në kuadër të projektit TEAVET janë akredituar nga MASR-ja dhe Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, ndërsa 13 programe të tjera TNGJJ, që lidhen kryesisht me tema pedagogjike, janë në proces akreditimi **[A1.1, C2, BM10]**. Krahas kësaj, të gjithë studentët që përfundojnë programe studimi Bachelor kanë mundësinë të ndjekin studimet në nivelin Master (shkencor ose profesional), ose të ndjekin studime të avancuara dhe specializime, nëse përfundojnë ciklin me sukses **[A1.1.2, Neni 51]**. UNIKO-ja ofron një larmi programesh studimi dhe me kohëzgjatje të ndryshme, nga 1 deri në 2 vjet për ato me profil profesional, si dhe Master Profesional në ciklin e dytë **[A 1.1.2, Neni 48]**. Megjithëse UNIKO-ja nuk ka mekanizëm për vlerësimin e përvojës së fituar dhe ndikimit të kurseve formuese, numri në rritje i pjesëmarrësve mund të konsiderohet si tregues pozitiv **[BM10]**. **Kapitulli I, Standardi I.2**

3.3 Bazuar te strategjia **[A1.3.1]** dhe statuti **[A 1.1.2]**, UNIKO-ja e fokuson ofertën akademike te cilësia e mësimdhënies dhe studimit për të mundësuar arsimim të përshtatshëm për zhvillimin e kompetencave të nevojshme që kërkohen në tregun e punës, falë bashkëpunimit ndërkombëtar, kërkimit dhe vlerësimin të rregullt të cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet mekanizmit të sigurimit të cilësisë dhe zbatimit të standardeve **[A1.3.2, RVV, f.35, BM8]**. UNIKO-ja ka përcaktuar vizionin dhe objektivat përkatës në Strategjinë 2022-2027, duke nënvizuar përfshirjen dhe bashkëpunimin me palët e interesit të zhvillimit rajonal, cilësinë e mësimdhënies akademike dhe kërkimit dhe respektimin e diversitetit social, si shtysat kryesore të zhvillimit të profesionistëve të së ardhmes **[A1.1.2, BM6]**. Gjatë zbatimit të kësaj Strategjie, UNIKO-ja do t'i kushtojë vëmendje të veçantë përmirësimit të programeve të studimit dhe zhvillimit të mëtejshëm shkencor të personelit akademik dhe trajnimit për riaftësimin/aftësimin e profesionistëve (TNGJJ), me qëllim identifikimin dhe reagimin e përshtatshëm ndaj nevojave të tregut **[A1.3.2, BM10]**. Bashkëpunimi i UNIKO-s me institucionet publike

<sup>5</sup> <https://teavet.org>; <https://entraltheproject.eu>

<sup>6</sup> <https://www.unkorce.edu.al/qendra-per-fromimin-e-vazhduar-2/>

vendase dhe kompanitë private u ofron studentëve mundësi për praktika profesionale të suksesshme dhe punësim të mundshëm pas diplomimit, një objektivi i nënvizuar gjatë takimit me një grup pedagogësh dhe përfaqësuesish të partnerëve të jashtëm dhe alumnit **[BM6]**. Falë këtij bashkëpunimi, tashmë puna është përqendruar te zgjatja e periudhës së praktikës profesionale për studentët sipas kërkesës nga palët vendore të interesit dhe studentët **[BM3, BM4, BM6]**. *Kapitulli I, Standardi I.3*

- 3.4 Të gjitha programet e studimit në UNIKO ofrohen duke ndjekur kuadrot ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare, në përputhje me sistemin e Bolonjës, pra, programet e studimit janë të integruara me sistemin lëndor të studimeve, ndërsa lëndët kanë ngarkesën përkatëse nëpërmjet krediteve (25 orë/kredit ECTS) **[A2.8, A2.9, A2.10]**. UNIKO-ja ofron programe studimi në përputhje me politikën e përgjithshme kombëtare, me synim konsolidimin e traditës shqiptare, ndërsa respektohet korniza evropiane e kualifikimeve dhe ajo ligjore **[A1.3.1]**. Megjithëse të pasurit e shumë disiplinave përbën një objektivi madhor gjatë krijimit të programeve të studimit, përfshirja e gjuhëve të huaja në të gjitha programet dhe nivelet konsiderohet si një faktor përmirësues për rritjen e mobilitetit të studentëve dhe personelit akademik **[RVV, f.36, BM10]**. Megjithëse aktualisht nuk ka program të përbashkët me IAL të tjera ndërkombëtare, UNIKO-ja është angazhuar dhe po përpiqet ta realizojë këtë objektivi nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte të ndryshme ndërkombëtare për promovimin e mobilitetit të studentëve dhe personelit akademik, si një element kyç i ndërkombëtarizimit **[A1.3.2, BM8]**. Në një takim me personelin akademik **[BM5]**. GVJ-ja konfirmoi se mobiliteti ndodh shpesh dhe lehtësohet nga institucioni **[BM10]**. Statuti i UNIKO-s i njej kreditet e grumbulluara nga studentët gjatë ndjekjes së studimeve në IAL të tjera **[A1.1.2, Neni 47]**. *Kapitulli I, Standardi I.4*
- 3.5 Ngarkesa mësimore e pedagogëve me kohë të plotë në UNIKO është 1536 orë mesatarisht, sipas Rregullores së Universitetit dhe Marrëveshjes Vjetore të Ngarkesës së Punës **[A 1.2, Neni 33, 39]**. Ngarkesa e punës së pedagogëve përfshin mësimdhënien, kërkimin, punën institucionale dhe bashkëngjitet kontratës **[A 3.10]**. Dokumentet dhe evidencat raportuese të mundësuar nga UNIKO-ja **[A 1.2, Neni 33, A 3.9, A 3.10]** mundësojnë informacion mbi ngarkesën e punës së pedagogëve gjatë vitit, duke e klasifikuar atë në mësimdhënie, punë laboratorike, asistencë gjatë procesit mësimor (kërkim, botime), veprimtari mbështetëse për institucionin, etj. **[A 3.9, A 1.27, BM5]**. Ngarkesa shtesë e pedagogëve financohet nga buxheti i UNIKO-s **[RVV 36, A 3.9]**. Përgjegjësit e departamenteve dhe qendrave shkencore janë gjithashtu të angazhuar në mësimdhënie, në përputhje me kuadrin ligjor **[BM10]**. *Kapitulli I, Standardi I.5*
- 3.6 Kurrikula e programeve të studimit për të gjitha njësitë akademike është e disponueshme në faqen e internetit të Universitetit <https://moodle.unkorce.rash.al/> ndërsa programet e caktuara të studimit dhe kurrikulat përkatëse janë të disponueshme në faqen e internetit të departamentit përgjegjës për ofrimin e programit të studimit <https://moodle.unkorce.rash.al/course/index.php?categoryid=2> **[BM3, BM4]**. Objektivat e programeve të studimit përputhen me objektivat e përgjithshëm të UNIKO-s dhe përfshijnë mundësitë e punësimit, kriteret e pranimit, procedurat e diplomimit, rregullat e ndjekjes së studimeve, format e vlerësimit dhe syllabuset e programit **[A2.7, A2.8]**. Kriteret e pranimit të studentëve respektojnë ligjet dhe kuotat e përcaktuara në nivel kombëtar, të miratuara nga Senati **[A2.27, A1.1.1 Neni 46, A1.2**

**Neni 55, 57]** dhe janë publikuar në faqen e internetit të Universitetit **[A1.6]**. Kur vizitoni faqen e kursit, faqja e internetit ofron syllabusin e kursit për çdo program studimi, që i bën të mundur personelit, studentëve dhe studentëve të mundshëm ta aksesojnë lehtësisht këtë informacion (shihni <https://moodle.unkorce.rash.al/>) **[BM3, BM4]**.  
**Kapitulli I, Standardi I.6**

3.7 Statuti i UNIKO-s përcakton se studimet janë organizuar në tri cikle të njëpasnjëshme, duke u referuar niveleve 6, 7 dhe 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Statuti shpjegon kalimin ndërmjet këtyre tri niveleve **[A1.1.2, Neni 47]**. Të gjitha programet Bachelor të ciklit të parë (d.m.th. 3-vjeçare) përfshijnë 180 kredite ECTS dhe u mundësojnë studentëve vijimin e studimeve të tyre në nivelin e dytë Master (Shkencor ose Profesional), si në çdo IAL tjetër **[A1.2 Neni 52]**. Masteri Profesional organizohet në 60/120 kredite ECTS, ndërkohë që UNIKO ofron 7 programe studimi 2-vjeçare të nivelit të 5-të të kualifikimit, për ofrimin e ekspertizës së specializuar në fusha profesionale (joshkencore) **[A1.3.2, A 1.2 Neni 53, RVV f.38]**. Njësitë akademike të UNIKO-s kanë krijuar programe studimi në përputhje me ndarjen në disiplina si lëndë bazë, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore dhe lëndë plotësuese, që i pajisin studentët me njohuritë bazë të profesioneve përkatëse dhe parimet shkencore, ndërsa programet profesionale fokusohen më tepër tek aftësi të caktuara **[A1.1.1 49, RVV f. 38]**. Në përgjithësi, studentët mendojnë se programet aktuale të studimit dhe organizimi i njësive akademike i pajisin ata me kompetenca të përgjithshme dhe të veçanta, si dhe me formim të përshtatshëm, ndërsa u ofrojnë dhe mundësi për zgjerimin dhe thellimin e mëtejshëm të fushave përkatëse të studimit, duke u ofruar mundësi më të mira punësimi **[BM3, BM4]**. Nëpërmjet takimit me studentët dhe personelin administrativ, GVJ-ja vërejt se Shoqata e Alumnit në UNIKO është e pranishme dhe synon t'i ndihmojë studentët e sapodiplomuar që të kenë kontakte më të mira për mundësi punësimi, falë edhe partnerëve të jashtëm të institucionit **[BM3, BM4, BM9]**. Rregullorja e UNIKO-s **[A1.2 Neni 76]** përcakton rastet e transferimit të studentëve me parakushtin që transferimi të kryhet brenda të njëjtit cikël studimi, me vendimin e komisionit të posaçëm dhe në përputhje me aktet nënligjore kombëtare **[A3.1]. Kapitulli I, Standardi I.7**

3.8 Informimi falë fushatave të rregullta me nxënësit e shkollave të mesme lidhur me ofertën studimore dhe organizimin gjatë "ditëve të informimit të nxënësve" harmonizohet me aktivitetet e koordinuara nga Qendra e Karrierës dhe Alumni, për të siguruar përshtatjen e lehtë të studentëve gjatë vitit të parë të studimeve **[A3.24.1]**. Gjatë takimeve me GVJ-në, studentët konfirmuan **[BM3, BM4]** se orientimi i tyre mbështetet më tej nga faqja e internetit e Universitetit, ku mund të gjejnë të gjithë informacionin e nevojshëm për organigramën e UNIKO-s dhe kontaktet e zyrave kryesore për adresimin e pyetjeve të tyre, siç është Qendra e Karrierës. UNIKO-ja kryen një sërë veprimtarish për sigurimin e cilësisë në nivele të ndryshme (programe studimi dhe njësi bazë), që përfshijnë studentët dhe personelin mësimor **[A3.28.1, BM4, BM5, BM9]**. Rezultatet e mbledhura diskutohen në nivel departamenti në analiza të posaçme, që më pas i paraqiten Dekanatit dhe fakulteteve, për të vendosur mbi hapat që do të ndërmerren **[BM5, BM9]**. Mjetet e tjera përfshijnë analizën e performancës së studentëve, normën e diplomimit kundrejt normës së regjistrimit në vitin e parë për çdo kurs dhe përmirësimet e përshtatshme të programeve nga njësitë bazë **[A2.5, BM10]**. Rregullorja e UNIKO-s dhe Rregulloret përkatëse të programeve të studimit ofrojnë një përmbledhje të qartë të veprimtarive me interes për studentët



gjatë nisjes së kurseve, por edhe gjatë studimeve akademike [A1.2, A2.7, A2.8]. Sistemi Pitagora online mundëson syllabusin e kurseve për çdo program studimi dhe u ofron studentëve informacion të qartë, ndërsa redukton hapat proceduralë [BM3, BM4, BM9]. UNIKO-ja promovon zhvillimin në karrierë të studentëve nëpërmjet bursave për studentët me rezultate të larta [BM3, BM4, BM9]. Evidencat tregojnë se raporti i personelit akademik me kontratë ndaj atij me kontratë të përkohshme është, përkatësisht, rreth 84%/16% [A 3.15] ndërsa numri i personelit mësikor për student është rritur nga 1/30 në vitin 2016, në 1/21 në vitin 2021, çka ka ndihmuar më tej me rritjen e cilësisë, megjithëse kjo vjen kryesisht nga zvogëlimi i numrit të studentëve sesa nga rritja e numrit të PAE (që është thujse njësoj) [A1.3.2]. Këto shifra, por edhe shqyrtimi i hollësishëm i evidencave të paraqitura, tregojnë se ky ekuilibër mirëmbahet jo vetëm në nivel universiteti, por edhe në nivel fakulteti dhe programesh studimi [BM5]. Strategjia e Zhvillimit 2022-2027 [A 1.3.1] synon rritjen e nivelit të kualifikimeve të personelit akademik, ndërsa sistemi i pikëzimit favorizon personat me nivelin më të lartë të kualifikimit. **Kapitulli I, Standardi I.8**

- 3.9 Programet e studimit të ciklit të dytë hartohen nga personeli akademik i departamenteve bazuar te kërkimi, ekspertiza e fituar dhe nëpërmjet procesit të marrjes së vërejtjeve nga vlerësimi i studentëve [A.2.36, BM9, BM10]. Sipas Rregullores së UNIKO-s [A1.2 Neni 34], ngarkesa e punës ndahet ndërmjet veprimtarive, si: a) mësimdhënia; b) kërkimi shkencor; c) kontributi institucional. Gjatë takimit me pedagogët, GVJ-ja u informua se 20% e kohës së tyre i kushtohet kërkimit, pjesëmarrjes në konferenca ndërkombëtare dhe bashkëpunimit në projekte kërkimore, duke përfshirë punën për përmirësimin e kurrikulave të programeve të studimit dhe pjesëmarrjen në detyrat akademike të departamentit [BM5]. Personeli i nivelit të lartë me kohë të plotë merr përsipër një ngarkesë mësimore më të madhe, për t'u mundësuar kolegëve më të rinj më shumë kohë për kualifikim profesional [BM5, BM10]. Rreth 80% e kohës së punës i kushtohet veprimtarisë mësimore, e ndarë në përgatitje personale për mësimdhënie, mësimdhënie e drejtpërdrejtë, konsultime dhe udhëheqje për diplomat [A1.2 Neni 34, BM5]. Përgatitja e diplomës, d.m.th. shablloni, pritshmëritë, kërkesat dhe hapat e nevojshëm, pra mbështetja akademike, procedurat lidhur me mbrojtjen e tezës, etj., përcaktohen në manualin përkatës [A2.15.1]. Praktikant profesionale janë një pjesë kurrikulare e kryer në bashkëpunim me kompanitë private dhe ato shtetërore, dhe përmbillen me një vlerësim të posaçëm të veprimtarisë [A2.21, BM6]. Qendra e Karrierës ka të dhëna të plota për punësimin e të diplomuarve dhe gjurmimin e alumnit [A2.30, BM9]. Integrimi më i mirë i këtyre të dhënave dhe vërejtjeve të punëdhënësve ndihmojnë për krijimin e një panorame të plotë të nevojave të tregut të punës dhe marrjen e vërejtjeve për rishikimin e programeve të studimit [A 2.29.1, BM6]. Kur ka qenë e nevojshme dhe e mundur, UNIKO-ja ka ftuar personel akademik vendas dhe të huaj ose persona me ekspertizë në një fushë të caktuar [A3.3, BM10]. **Kapitulli I, Standardi I.9**
- 3.10 Statuti i UNIKO-s përcakton se studimet janë organizuar në tri cikle të njëpasnjëshme, duke u referuar niveleve 6, 7 dhe 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, ndërkohë që dhe kalimi ndërmjet këtyre tri niveleve parashikohet në statut [A1.1.1, Neni 46]. Të gjitha programet Bachelor të ciklit të parë (d.m.th. 3-vjeçare) organizohen në kurse me 180 kredite ECTS dhe u mundësojnë studentëve vijimin e studimeve të tyre në nivelin e dytë Master (Shkencor ose Profesional) [A1.2 Nenet 54, 56, 58, 71]. Mbështetur te strategjia e UNIKO-s, bashkëpunimi ndërkombëtar përbën prioritet, krahas mobilitetit

të pedagogëve dhe studentëve në programe të ndryshme **[A1.1.2, A 3.13]**. GVJ-ja vëren se programet e studimit në UNIKO synojnë lehtësimin dhe kryerjen e mobilitetit **[BM1, BM5, BM10]** për promovimin e bashkëpunimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar **[A1.2, Neni 63]**. Në përfundim të programeve të studimit, të ciklit të parë dhe të dytë, studentët pajisen me diplomë dhe suplement diplome në gjuhën shqipe dhe atë angleze **[A2.12.1]**. Gjatë takimeve me studentët e ciklit të dytë të studimeve, GVJ-ja identifikoi se njohuritë e gjuhëve të huaja janë në nivel të kënaqshëm **[BM4]**. Statuti i UNIKO-s përcakton kriteret e pranimit për studentët në ciklin e dytë të studimeve, duke përfshirë dhe njohjen e gjuhës së huaj përkatëse për programin e studimit **[A1.1.1 Neni 53]**. UNIKO-ja e ushtron njohjen deri në 75% ekuivalentim në rastet e mobilitetit në çdo program studimi **[A3.2, A1.23, BM9]**. **Kapitulli I, Standardi I.10**

- 3.11 Programet e studimit kombinojnë komponentin teorik dhe atë praktik të njohurive, ndërsa përcaktojnë ekuilibrin e duhur ndërmjet lëndëve karakterizuese, ndërdisiplinore dhe integruese **[A2.12, RVV f. 41]**. Në varësi të programit të studimit, mënyrat e aplikimit praktik variojnë nga veprimtaritë praktike te laboratorët **[A2.15, BM3, BM4]**. Provimet përfundimtare të diplomimit dhe praktikat profesionale përfshihen në programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë **[A1.5 Neni 69, BM9]**, ndërsa UNIKO-ja synon përputhjen e përshtatshme ndërmjet programit të studimit dhe institucioneve të stazhit/praktikës **[A3.25, BM4]**. UNIKO-ja mban evidenca të punës së studentëve gjatë stazhit dhe vlerësimit të performancës së tyre nga pedagogët **[A3.2, BM9]**. Gjatë takimit me studentët, GVJ-ja konstatoi se përfshirja e tyre në projekte kërkimore fokusohet kryesisht te pyetësorët dhe puna në terren **[BM4, BM5]**. Gjatë programit të studimit, UNIKO-ja ofron mbështetje nëpërmjet këshillimit dhe informimit, si dhe nëpërmjet identifikimit të praktikave dhe mundësive të tjera për pjesëmarrjen e studentëve në veprimtari praktike **[A3.4, A3.24.1]**. **Kapitulli I, Standardi I.11**
- 3.12 Në UNIKO, personeli i departamenteve dhe fakulteteve synon përfshirjen e disiplinave karakterizuese (me fokus profesional) në masën e 90-99 kredite ECTS, të barasvlershme me 50-55% të ngarkesës së të gjithë programit të studimit, ndërsa projektet karakterizuese dhe integruese përbëjnë 18% **[BM5, BM10]**. UNIKO-ja i kushton vëmendje të veçantë integritit të programeve të ciklit të dytë me karakter profesional me nevojat për ekspertizë të palëve vendore të interesit, objektivat rajonale të zhvillimit strategjik, nevojat e tregut dhe vërejtjet e marra, për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë e kërkuara nga studentët për disiplinën e kualifikimeve profesionale **[A2.8, A 2.9, A 2.10 RVV f.42, BM10]**. Programet e studimit në të gjitha nivelet u ofrojnë studentëve kompetenca profesionale të përgjithshme dhe të veçanta, me qëllim ndërtimin e një profili profesional të dëshirueshëm në tregun e punës **[A1.1.2, BM10]**. Krahas kësaj, një kriter kyç për krijimin e programeve të reja të studimit lidhet me arsyetimin e programit të studimit kundrejt nevojave të tregut të punës, që do të mbulohen nga studentët e diplomuar **[A1.2 Neni 46, A 2.4]**. Praktika profesionale kryhet në të dyja nivelet e studimit dhe në të gjitha programet **[A 3.2]**. Gjatë vizitës së GVJ-së në ambientet e UNIKO-s, prania e infrastrukturës mësimore, si laborator i infermierisë, bujqësisë, salla e praktikës pedagogjike, etj., dhe pajisjet e tyre, dëshmuuan punën e studentëve sa i përket formimit praktik **[BM11]**. **Kapitulli I, Standardi I.12**

## Gjetje

### Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikën e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Kurrikula, në disa departamente, si mësimdhënia dhe studimet bujqësore, është përmirësuar në masën 80%, falë vërejtjeve të studentëve dhe palëve të interesit. **(Kapitulli I, Standardi I.1)**

### Pikat e dobëta

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë pikë të dobët.

### Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- Duhet ndjekur një qasje e fokusuar te mënyra e rritjes së numrit të studentëve. **(Kapitulli I, Standardi I.1)**

### Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë:

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimet e ndërmarra si më poshtë:

- Diferencimi më i mirë i kurrikulave të programeve të studimit gjatë dy viteve të para të BA-së në Fakultetin e Ekonomisë, duke marrë në konsideratë dhe përvojën e universiteteve të tjera **(Kapitulli I, Standardi I.1)**

## Gjykimi

**Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht.**

## Fusha e vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

4.1 Fakultetet e UNIKO-s janë të përfshira në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit lidhur me zhvillimet shkencore dhe sociale novatore, që kërkohen nga: zhvillimet e reja të kontekstit rajonal ose kombëtar, rezultatet novatore të kërkimit nga personeli, gjetjet e raporteve të vetëvlerësimit dhe nevojat e të nxënimit të studentëve të regjistruar së fundmi **[RVV, f. 44]**. Të gjitha programet e studimit diskutohen në departamentet përkatëse dhe, më pas, versioni përfundimtar i miratuar dërgohet në Rektorat dhe, pas miratimit nga Senati Akademik, nënshkruhet nga Rektori, Dekani i Fakultetit dhe nga Përgjegjësi i Departamentit **[BM10]**. Kopjet e shtypura të programeve ruhen në arkivat e fakultetit përkatës dhe u vendosen në dispozicion personelit akademik dhe studentëve në format elektronik. Syllabuset përfshijnë përmbajtjen e kurrikulës, objektivat e programit, shpërndarjen e krediteve dhe ngarkesën, si dhe formatet e mësimdhënies, të nxënimit dhe vlerësimit. Syllabuset përgatiten nga pedagogët dhe diskutohen në departament, me qëllim shmangien e dublimit dhe mbivendosjes **[A1.2, A1.1.1, A2.13, BM5, BM10]**. Përgjegjësi i Departamentit përlogarit ngarkesën mësimore dhe të të nxënimit të disiplinës, duke u bazuar te hapësira përkatëse në planin mësimor. Pedagogët i përditësojnë vazhdimisht materialet mësimore dhe i ruajnë të dhënat e veprimtarisë mësimore në dosjet e tyre personale ose në regjistër **[A1.14, A1.2, BM10]**. Regjistri i personelit akademik është një dokument zyrtar themelor, që identifikon pjesëmarrjen e studentëve dhe rezultatet e tyre, si dhe shërben që çdo pedagog të shënojë titullin e disiplinës, programit të studimit, kursit përkatës, vitin akademik, elementet mësimore të mësimimit të zhvilluar, dhe të shënojë mungesat dhe rezultatet e studentëve, si dhe elementet që përcaktojnë aspektet e vlerësimit të vazhdueshëm, të parashikuar në syllabusin e kursit ose në modul **[RVV, f. 44, BM5]**. Regjistri njihet si dokumenti zyrtar që verifikon ngarkesën e punës së pedagogut dhe kontrollon sistematikisht nga përgjegjësi i departamentit **[A3.11.2, BM5, BM10]**. Krahas provimit me shkrim, studentët vlerësohen edhe nëpërmjet detyrave/projekteve të kursit, punës laboratorike, etj. **[A2.15.3, BM3, BM4]**. Kurrikula përfshin pjesë teorike, punë praktike, orë ushtrimore, seminare, orë diskutimi, prezantim projektësh, përgatitje të detyrave të kursit, diskutime në auditor dhe orë laboratorike **[RVV, f. 44, BM5, BM10]**. Gjithashtu, UNIKO-ja përmirëson rregullisht infrastrukturën dhe laboratorët, me qëllim pasurimin e metodologjisë praktike të të nxënimit **[A3.20; BM2]**. Studentët i shprehën Grupit të Vlerësimit të Jashtëm se e vlerësojnë përmirësimin e laboratorëve dhe rritjen e numrit të orëve laboratorike **[BM3, BM4]**. Departamentet përkatëse janë përgjegjëse për zhvillimin e veprimtarive praktike të studentëve. Çdo syllabus përcakton orët e punës së pavarur të studentëve, orët e seminareve ose punës laboratorike dhe, në varësi të natyrës së programit, orët praktike në terren **[BM10]**. Megjithatë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ka marrë kërkesa nga studentët, institucionet dhe kompanitë nga sektori privat dhe ai publik për zgjatjen e periudhës së praktikave profesionale në të ardhmen, pasi, aktualisht, e konsiderojnë këtë periudhë si të shkurtër **[BM3, BM4, BM6]**. Rregullat e menaxhimit dhe mbikëqyrjes së praktikës profesionale përcaktohen në Rregulloren e organizimit dhe veprimtarisë mësimore dhe kërkimore shkencore, përkatësisht në Nenet 115 dhe 116 **[A1.2]**. Njësitë bazë zgjedhin anëtarë personeli për monitorimin e ecurisë së praktikës në terren **[BM4, BM5]** në mënyrë që, ndër të tjera, të sigurojnë ndërveprimin profesional të studentëve me institucionet ku kryejnë

praktikën dhe që ata të fitojnë sa më shumë aftësi nga praktika e tyre **[BM4, BM5, BM6]**. Vlerësimi i studentëve kryhet nga mbikëqyrësit dhe shënohet në formularin e vlerësimit **[A3.25, BM4, BM5]**. Studentët e disa programeve hartojnë dhe prezantojnë/mbrojnë punime mbi problematikat që kanë hasur gjatë praktikës **[BM5]**. Me qëllim përmirësimit të procedurave të praktikës dhe rritjen e përgjegjësisë së mentorëve dhe drejtësisë në vlerësim, departamentet kanë zhvilluar udhëzime mbi praktikën mësimore **[A2.15.1]**. Gjithashtu, departamentet janë përgjegjëse edhe për monitorimin e punës kërkimore dhe projekteve të kursit, që përfshihen në syllabus dhe janë pjesë e vlerësimit të vazhdueshëm të studentëve. Në veçanti, departamenti kryen monitorimin e veprimtarisë kërkimore të studentëve gjatë përgatitjes së tezave të diplomës, të cilat diskutohen paraprakisht dhe orientohen nëpërmjet mbikëqyrjes së vazhdueshme **[RVV, f. 45, BM4, BM5]** nga udhëheqësit e diplomës, të cilët miratohen nga Përgjegjësi i Departamentit **[A 2.15.1, BM4, BM5, BM10]**. Megjithatë, përfshirja e studentëve në projekte kërkimore nuk është në nivel të kënaqshëm **[BM4, BM5]**. Pedagogët e lëndëve përkatëse u mundësojnë studentëve materiale mësimore dhe literaturë në formën e librave shkollorë, leksioneve, manualeve, dokumentacionit elektronik, punimeve të mëparshme nga studentë të tjerë, media komunikimi dhe programe të teknologjisë së informacionit, etj. **[A2.16, BM4, BM5, BM10]**. Studentët mund të marrin materiale nga bibliotekat e fakultetit ose nga Biblioteka Shkencore, ose mund t'u referohen burimeve *online*, të sugjeruara nga pedagogu i lëndës **[RVV, f. 45, BM4, BM5, BM9]**. UNIKO-ja është duke kryer digjitalizimin e bibliotekës nëpërmjet projektit të mbështetur nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) dhe ka akses të burimeve elektronike të JSTOR-it **[BM8, BM9]**. Pavarësisht kësaj, shumica e personelit akademik është përfshirë në mesimdhënie dhe duket se janë më pak të angazhuar në kërkim, megjithëse grupet kërkimore janë krijuar **[BM6]**.

**Kapitulli I, Standardi II.1.**

- 4.2 Në Rregulloren e organizimit dhe veprimtarisë mësimore dhe kërkimore shkencore, UNIKO-ja përcakton organizimin e formave të vlerësimit, kolegumeve, provimeve dhe provimeve/punimeve të diplomimit në të gjitha programet e studimit **[RVV, f. 45. A 1.2]**. Pjesët e rëndësishme të Rregullores së lartpërmendur afishohen në tabela informuese gjatë periudhave të ndryshme të vitit akademik, po ashtu dhe në monitorët e vendosur në korridoret e fakulteteve **[Vizita orientuese]**. Nenet, që përcaktojnë rregullat e vlerësimit dhe procedurat e provimit, shfaqen në monitorë gjatë periudhave të provimeve **[RVV, f. 45]**. Përpara provimit të diplomimit, pedagogët i informojnë studentët rreth normave të vlerësimit të vazhdueshëm dhe u ofrojnë pyetjet që përkojnë me standardet e përcaktuara në rezultatet e të nxënit për çdo disiplinë **[A2.15.2, BM4]**. Studentët në UNIKO informohen lidhur me formën e vlerësimit të kursit, provimet dhe diplomimin nëpërmjet sekretarisë studentore *online* ESSE3/ bazë së të dhënave në Pitagora, dhe shërbimit *online* në faqen e internetit të Universitetit **[https://unk.pitagora.rash.al/]**, ndërsa, për rezultatet e provimeve, ata njoftohen brenda afatit të parashikuar në Rregullore **[A1.2, BM3, BM4]**. Përgjegjësit e personelit akademik, punonjësit e sekretarive mësimore dhe autoritetet e njësive që menaxhojnë provimet respektojnë afatet dhe i hedhin të dhënat në bazën elektronike të të dhënave sipas parashikimit në Doracakun për Programin e Digjitalizimit të Sistemit Universitar **[A1.6, BM5]**. Informacioni për vlerësimin e provimeve është i disponueshëm vetëm për përdoruesit e autorizuar **[A1.6, BM9]**, duke siguruar konfidencialitetin **[A1.9]**, ndërsa ankesat e studentëve për notat e provimeve shqyrtohen sipas procedurave të përcaktuara në Nenin 54 të Rregullores së organizimit dhe veprimtarisë mësimore dhe

kërkimore të UNIKO-s [RVV, f. 46, BM3]. Nëpërmjet platformës Cleanscore, në semestrin e parë të vitit akademik 2021-2022, UNIKO-ja realizoi një projekt pilot për vlerësimin elektronik të provimeve për të rritur objektivitetin e vlerësimeve [A2.26]. Pavarësisht sfidave të hartimit të provimeve të përshtatshme për sistemin, procedura ka funksionuar mirë edhe me grupe të mëdha studentësh [RVV, f. 46 <https://cleanscore.al/arkiva/category/provimeve/universiteti-fan-s-noli-korce>].

Procedurat e diplomimit, format e provimeve të diplomimit, forma e diplomës dhe suplementit, si dhe procedurat e bazës së të dhënave që regjistron lëshimin e diplomave në UNIKO, janë përcaktuar në përputhje me Rregulloren e organizimit dhe veprimtarisë mësimore dhe kërkimore shkencore [A1.2, BM9]. Diplomat e programeve të studimit dhe suplementet përkatëse regjistrohen në Regjistrin Kombëtar të Diplomave dhe Certifikatave për Arsimin e Lartë dhe njihen si dokumente ligjore që vërtetojnë përfundimin e programeve përkatëse të studimit [RVV, f. 46] *Kapitulli I, Standardi II.2.*

- 4.3 Programet e studimit që u ofrohen studentëve u nënshtrohen procedurave të vlerësimit të cilësisë nga njësitë e sigurimit të brendshëm të cilësisë, organet vendimmarrëse, autoritetet, personeli akademik, studentët dhe palët e ndryshme të interesit [BM6, BM10]. Fillimisht, kurrikula rishikohet duke u bazuar te propozimet e departamenteve, argumentet e të cilave mbështeten kryesisht te numri dhe cilësia e studentëve të regjistruar, si dhe te nevoja për rinovimin e ofertës akademike [RVV, f. 46]. Pas analizës nga njësitë e sigurimit të brendshëm të cilësisë lidhur me palët e interesit të përfshira në programet e studimit, fillon rishikimi i kurrikulave të programeve, bazuar te të dhënat e marra nga pyetësorët dhe sondazhet me studentët [BM3, BM4]. Megjithatë, në të ardhmen, kërkohet një përfshirje më e madhe e palëve të jashtme të interesit, si bashkia dhe kompanitë private [BM6]. Numri dhe cilësia e studentëve të regjistruar masin ecurinë e një programi studimi [RVV, f. 46] krahas gjurmimit të të diplomuarve, nga ku mund të shihet përqindja e të punësuarve në profilin përkatës [A2.30, BM6]. Në këtë drejtim, UNIKO-ja deklaron se [RVV, f. 46] të diplomuarit kanë sugjeruar përmirësimin e infrastrukturës lidhur me mësimdhënien, si: përdorimi i laboratorëve, përditësimi i dokumentacionit, përfshirja e mjeteve të teknologjisë së informacionit në disiplina të caktuara, ndryshimi i normës së ngarkesës së disiplineve, përfshirja e njohurive të reja mbi kërkesat e tregut, metodat e mësimdhënies, metodat e vlerësimit, etj. Të gjitha gjetjet e lartpërmendura, por edhe të tjera lidhur me cilësinë e studentëve, rëndësia e kërkimit akademik në fushën e kurrikulave, etj., pasqyrohen në raportin e vetëvlerësimit nga NjSBC-ja [A3.28]. Analiza vjetore e veprimtarisë mësimore, shkencore dhe financiare të Universitetit përshkruan gjendjen aktuale të programeve të studimit dhe përcakton udhëzime për përmirësimin e treguesve kyç të sigurimit të cilësisë së programeve të studimit [A2.4, BM2]. Performanca e personelit akademik vlerësohet nëpërmjet pyetësorëve të zhvilluar me studentët, vlerësimit të kryer nga autoritetet dhe nëpërmjet informacionit individual të dhënë nga pedagogët në lidhje me veprimtarinë e tyre mësimore dhe kërkimore vjetore. Krahas kësaj, Dekanët dhe përgjegjësit e departamenteve kryejnë rishikim të rregullt të dokumentacionit që lidhet me programet e studimit [A3.30, A1.2, A3.27, BM3, BM4, BM10] *Kapitulli I, Standardi II.3.*

- 4.4 Sektori i Kurrikulës, Vlerësimit Institucional dhe Alumni është përgjegjës për matjen e treguesve kyç të performancës së programeve të studimit dhe për hartimin e planeve të punës për përmirësim të mundshme, [A1.5], siç parashikohet në Doracakun e

Sigurimit të Cilësisë së Universitetit **[A1.16]**. Sektori i Kurrikulës, Vlerësimin Institucional dhe Alumni koordinon punën ndërmjet Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në fakultete dhe raporton drejtpërdrejt tek autoritetet e Universitetit për masat që duhen ndërmarrë. NjSBC-ja kryen vlerësim periodik të efektivitetit të veprimtarive arsimore dhe shkencore, gëzon autonomi operative dhe ka akses te të dhënat universitare **[RVV, f. 47, A 1.1, A3.22]**. Edhe personeli akademik është i përfshirë në çështje që lidhen me sigurimin e cilësisë. Anëtarët e ekipit të projektit janë përfshirë në organizimin e trajnimeve me personelin akademik lidhur me përmirësimin e metodologjisë dhe infrastrukturës mësimore [\[http://unkorce.edu.al/kerkimi-shkencor-2/\]](http://unkorce.edu.al/kerkimi-shkencor-2/). Megjithatë, në të ardhmen, UNIKO-ja duhet të angazhohet më shumë për trajnime shtesë të personelit akademik për mësimdhënien. Qendra për Formimin e Vazhduar duhet të planifikojë më shumë trajnime për personelin dhe trajnuesit e personelit, për ndjekjen e trajnimeve mbi metodat e reja të mësimdhënies, veçanërisht mësimdhënies *online*. Gjithashtu, edhe mobiliteti i personelit dhe studentëve ka sjellë inovacione sa i përket metodologjisë dhe literaturës së përdorur në programe **[RVV, f. 47, BM4, BM8]**. Rektorati bashkërendon hartimin e planeve mësimore dhe orarit të kurseve për të gjitha programet e studimit, me qëllim menaxhimin e duhur të infrastrukturës së disponueshme. Menaxhimi rrit pjesëmarrjen e studentëve në veprimtaritë mësimore dhe shmang shtyrjen e mësimin në orët e vona të pasdites, ndërsa Fakultetet kujdesen t'i menaxhojnë më mirë auditorët, duke përfshirë laboratorët dhe ambientet e tjera që ofrohen për personelin mësimor dhe studentët **[RVV, f 47]**. Është shumë inkurajuese që personeli akademik ka qenë dhe vijon të jetë i përfshirë në projekte të ndryshme Erasmus+ për ngritjen e kapaciteteve, dhe fokusi është te përmirësimi i proceseve, strukturave dhe instrumenteve për përmirësimin e kurrikulave **[A3.17.1, BM2, BM5, BM8]**. Përfshirja e personelit akademik në projekte ndërkombëtare, si: SmartAI-Master në inovacione evropiane për menaxhimin e qëndrueshëm të territoreve shqiptare; Zhvillimi i kompetencave të pedagogëve për një sistem AFP-je gjithëpërfshirës në Shqipëri; Harmonizimi dhe inovacioni në programet e studimeve doktorale për Shëndetin e Bimëve në Bujqësinë e Qëndrueshme; Përmirësimi i kompetencave të mësimdhënies në arsimin e lartë në shkencat natyrore dhe matematikore (TeComp); Zhvillimi ekonomik i njohurive në Sektorin Ushqimor; Fuqizimi i Zyrave të Transferimit Teknologjik në universitetet shqiptare; Aftësitë sipërmarrëse për një arsim modern në Shqipëri; QUADIC- Zhvillimi cilësor i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe menaxhimit të projekteve; VALEU-X- Shkëmbimi virtual ndërmjet universiteteve shqiptare dhe atyre evropiane, Kurrikula të dyfishta - Studim dhe praktikë pune në Bujqësi dhe Siguri Ushqimore, ka mundësuar përmirësimin e kurrikulave dhe rezultateve të të nxënit **[RVV, f. 48, A 3.22]**. Ofertat lidhur me programet e reja të studimit janë pjesë e diskutimeve në mbledhjet e mbajtura në departamente ose fakultete. Më e rëndësishmja, edhe infrastruktura e teknologjisë së informacionit e disponueshme për programet e studimit është pjesë e këtyre diskutimeve, dhe personeli akademik po punon fort për ta përfshirë në veprimtaritë e zhvilluara në auditorë **[BM8, Vizita orientuese]**. Pavarësisht kësaj, bazuar te buxheti i vitit 2021, fondet e alokuara për kërkimin shkencor janë të pamjaftueshme dhe, nisur nga mbledhjet e ndryshme, u deklarua se shuma për kërkimin dhe botimin është rreth 50.000 euro **[BM2, BM6]**. Megjithatë, është shumë inkurajuese që buxheti për kërkimin do të rritet me 75% vitin e ardhshëm **[BM2] Kapitulli I, Standardi II. 4.**

- 4.5 Në UNIKO, departamenti është njësia bazë mësimore dhe kërkimore, me fokus te fushat kërkimore homogjene ose të ngjashme me ato të mbuluara nga personeli

akademik, dhe i koordinon ato me mësimdhënien **[A2.6, A3.5, BM10]**. UNIKO-ja përbëhet nga pesëmbëdhjetë departamente, që promovojnë dhe koordinojnë veprimtaritë kërkimore sipas profileve/kualifikimeve, dhe 75% e personelit akademik zotëron tituj dhe grada akademike **[A2.1, A3.14, A3.12, BM10]**. Megjithëse departamentet kanë burime njerëzore të mjaftueshme, me kualifikime të përshtatshme për ngritjen e kapacitetit kërkimor në fushat e studimit, ato nuk kanë realizuar shumë projekte kërkimore të zakonshme gjatë viteve të fundit. Megjithatë, është inkurajuese që 25% e asistentë pedagogëve akademikë janë në proces kualifikimi, përfundimi të studimeve të doktoraturës ose janë në pritje të hapjes së programeve të ciklit të tretë të studimeve në fushat përkatëse. Në UNIKO, departamentet janë burimi nxitës i veprimtarisë mësimore dhe kërkimore, dhe po ndërgjegjësohen gjithnjë e më shumë për rolin e tyre në tërësinë e funksionimit të Universitetit **[BM5]**. Departamentet organizojnë mbledhje të rregullta për bashkërendimin e veprimtarive kërkimore dhe botuese, promovimin e veprimtarisë kërkimore të personelit dhe për shkallën e shtrirjes së veprimtarisë kërkimore në kurrikulat e programeve të studimit **[A2.34]**. Megjithatë, në të ardhmen nevojitet një organizim më i mirë i grupeve kërkimore në departamente, megjithëse kjo është tejte e vështirë, pasi departamentet nuk kanë fonde të veçanta dhe buxheti është i centralizuar **[BM10]**. Kjo gjë konfirmohet edhe në RVV, ku shpjegohet se departamentet duhet të luajnë një rol më aktiv sa i përket kryerjes së kërkimit të aplikueshëm në kontekstin social, ekonomik, rajonal ose kombëtar **[RVV, f 48-49]**. Performanca e përgjithshme e departamentit është pjesë e proceseve monitoruese të Rektoratit dhe diskutimeve të Senatit Akademik **[A2.4, BM10]**. Megjithatë, departamentet përkatëse kanë organizuar veprimtari të përbashkëta me universitete rajonale ose kombëtare në Shqipëri, Greqi, Maqedoninë e Veriut, Kosovë dhe

Itali

<https://m.facebook.com/unkorce/photos/a.770203993004323/4128378353853520/>

<https://www.facebook.com/unkorce/posts/3334452013246162/>

<https://www.facebook.com/unkorce/posts/4841049389253076/>, si dhe tryeza të

rumbullakëta për diskutimin e drejtimeve të zhvillimit në rajon. Fitorja e projektit “Digjitalizimi i Bibliotekës së UNIKO-s” nga UNIKO-ja është shumë e rëndësishme, pasi ky projekt synon krijimin e fondit digjital të bibliotekës dhe katalogimin dhe indeksimin e plotë të saj, për ta bërë të disponueshme për lexuesit e interesuar jashtë Universitetit **[A3.22.1, BM9]**. Njëkohësisht, UNIKO-ja po punon për përmirësimin e kapacitetit të laboratorëve të ngritur pranë njësive, në mënyrë që të përdoren për programet kërkimore që ofrojnë **[A3.20.2]**. Pavarësisht përpjekjeve për rritjen e rendimentit dhe cilësisë kërkimore, personeli akademik ia kushton kohën më të madhe të punës mësimdhënies, në një raport prej 80% mësimdhënie dhe 20% kërkim **[BM10]**. Është shkurajuese që UNIKO-ja nuk ofron mbështetje financiare shtesë për personelin akademik që dëshiron të botojë punime në revista ndërkombëtare me faktor ndikimi **[BM5, BM10]**. UNIKO-ja zbaton kryesisht projekte për ngritjen e kapaciteteve **[BM5, BM8, BM10]**, që fokusohen te përmirësimi i kapacitetit njerëzor nëpërmjet trajnimeve dhe kualifikimeve, përmirësimi i kapaciteteve infrastrukturore nëpërmjet ngritjes së laboratorëve të posaçëm për këtë qëllim, dhe te kryerja e vizitave studimore ndërmjet partnerëve. Gjithashtu, është shumë inkurajuese që njësitë bazë aplikojnë për projekte kërkimore infrastrukturore, të organizuara nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), dhe kanë fituar dy projekte, ndërkohë që kanë aplikuar edhe për projektet “Horizon 2020” dhe “Marie Curie” dhe, megjithëse nuk qenë të suksesshme në këtë drejtim, edhe kjo është diçka inkurajuese **[BM5, BM8]**

**Kapitulli II, Standardi I. 1.**



4.6 Në UNIKO, kërkimi shkencor konsiderohet si pjesë thelbësore e veprimtarisë akademike, e promovimit individual të personelit akademik dhe si pjesë modeste e veprimtarisë studentore. Puna kërkimore e zhvilluar si pjesë e portofolit shkencor të personelit akademik lidhet drejtpërdrejt me rritjen e reputacionit të institucionit sa i përket kërkimit **[A3.17]**. UNIKO-ja kryen veprimtari shkencore dhe kërkimore për të rritur cilësinë e mësimdhënies, formimin e studentëve me metodologji kërkimi moderne dhe me njohuri praktike të avancuara, si dhe për të krijuar asete materiale për zhvillimin e fakulteteve **[A2.13]**. UNIKO-ja e nxit personelin të marrë pjesë në aplikimet e projekteve kërkimore institucionale, fondet për të cilat janë parashikuar në buxhetin vjetor të institucionit **[A2.2.1]**. Buxheti kërkimor për periudhën 2019-2022 është rreth 40,000 euro, thirrja për projektet shpallet dy herë në vit, 20,000 euro shërbejnë për aspektin material (pajisje, laborator, etj.) dhe 20,000 euro për aspektin jomaterial (propozime për projekte kërkimore) **[BM7]**. Më e rëndësishmja, planifikohet që, në të ardhmen e afërt, buxheti për kërkimin të rritet deri në 150,000 euro **[BM10]**. Aktualisht, personeli akademik nuk mbështetet financiarisht për të marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare dhe për botimin e punimeve shkencore **[BM5, BM10]**. Nivelet e financimit diskutohen në Rektorat dhe, më pas, miratohen nga autoritetet vendimmarrëse, Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit. Pas kësaj, Rektori shpall thirrje për projekte kërkimore ose për infrastrukturën kërkimore institucionale të ofruar/aplikuar nga njësitë dhe personeli akademik përkatës **[A3.22.3]**. Projektet e mbështetura janë të fushave të ndryshme, si: kërkimi mbi reformimin e përmbajtjes dhe dokumentacionit të programeve të studimit, pasurimi i fondit të librave të bibliotekës, pajtimi në botime akademike periodike, blerja e pajisjeve për projekte kërkimore, botimi në librat shkollorë të universitetit dhe organizimi i aktiviteteve dhe punimeve shkencore **[A3.23]**. Buxheti mundëson fonde vjetore për pajisjen e bibliotekave të fakulteteve me materialet e kërkuara nga personeli akademik, që janë të disponueshme edhe për veprimtaritë kërkimore të studentëve **[A2.2, BM9]**. UNIKO-ja ka krijuar partneritete të qëndrueshme në konsorciume projektesh ndërkombëtare, kryesisht të Erasmus + **[A 3.22]**. Bashkëpunimi dhe rrjetet e krijuara bazuar te këto partneritete kanë përmirësuar më tej ndërveprimin dhe komunikimin shkencor ndërmjet kërkuesve, duke shërbyer si një mjet promovues për ndërkombëtarizimin ose për aplikimin kontekstual të rezultateve të tyre kërkimore **[RVV, f. 49]**. UNIKO-ja ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me 10 institucione kombëtare të arsimit të lartë, 30 institucione ndërkombëtare të arsimit të lartë dhe 92 marrëveshje bashkëpunimi me institucione joarsimore, me anë të së cilave siguron orientimin e kërkimit nëpërmjet veprimtarive të përbashkëta/botimeve dhe mobilitetit të personelit **[A3.31, BM2, RVV, f. 50]**. Është shumë inkurajuese që, në dy vitet e fundit, nga shtatë aplikimet e UNIKO-s për projektet shkencore të mbështetura nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, 2 janë vlerësuar pozitivisht dhe dy të tjera janë në fazë vlerësimi **[A3.22.2, BM5, BM8]**. Qendra Ndërdisciplinore e Studimeve Ballkanike sapo ka filluar veprimtarinë e saj në universitet dhe ka si mision koordinimin e veprimtarisë kërkimore të zhvilluar në Studime Ballkanike në nivel institucional dhe ndërinstitucional **[BM2, A1.22; A3.23]**. Ekonomia Didaktike Eksperimentale (EDE) është një njësi kërkimore me një sipërfaqe prej 16.5 ha pranë Fakultetit të Bujqësisë, që mundëson infrastrukturën për veprimtari të fushës për studentët, me kultura të ndryshme bimore, si drithërat, frutat, perimet, foragjeret dhe bishtajat. Studentët kryejnë teste krahasuese të mënyrave të rritjes së prodhimit dhe ndjekin raste studimore me zgjidhje praktike, që lidhen me njohuri teorike me natyrë të veçantë **[BM2, BM10, A1.8]**. EDE-ja

mundëson hapësirë infrastrukturore për ndërmarrjet eksperimentale shkencore të kërkuesve në këtë fakultet. Ajo paraqet një koleksion të plotë bimësh foragjere dhe një koleksion pemësh rajonale. Janë kryer studime mbi përshtatshmërinë e disa prej kulturave bimore të lartpërmendura me karakteristikat klimatike rajonale **[BM5, BM10, RVV, f. 50]**. Fakulteti ka interes ta shndërrojë këtë njësi në një qendër kërkimi të aplikuar, si pikë mbështetjeje për problemet bujqësore të fermerëve dhe për zhvillime të ardhshme bujqësore në rajon. Qendra do të kontribuojë për rritjen e mbështetjes kërkimore për projektet shkencore të ciklit të dytë dhe të tretë të programeve të studimit, që synojnë të kontribuojnë për gjenerimin e të ardhurave për të ardhmen [\[http://unkorce.edu.al/ede/\]](http://unkorce.edu.al/ede/), por nuk ka asnjë dokument zyrtar për këtë nismë.

#### **Kapitulli II, Standardi I. 2.**

4.7 Raportohet se **[RVV, f. 50]**, në pesë vitet e fundit, në UNIKO ka pasur një prirje drejt ndërkombëtarizimit të veprimtarisë shkencore dhe kjo tendencë vjen si rezultat i drejtpërdrejtë i disa faktorëve:

- Personeli akademik e ka promovuar punën kërkimore duke marrë pjesë në aktivitete ndërkombëtare (veçanërisht në konferenca jashtë vendit) dhe duke botuar punimet e tyre në revista ndërkombëtare **[A3.17]**.
- Partneritetet për projektet kanë përmirësuar më tej format e bashkëpunimit për realizimin e aspekteve të tjera të bashkëpunimit, si aplikimet shitesë në projekte, organizimi i aktiviteteve të përbashkëta, etj. Këto partneritete institucionale kanë rritur përpjekjet e ndërkombëtarizimit të UNIKO-s duke promovuar mobilitetin e personelit dhe duke i përfshirë në diskutime me një rrjet të gjerë kërkuesish **[A 3.31]**, por është e paqartë se në sa projekte shkencore është aplikuar me këta partnerë.
- Ekziston një tendencë në rritje për aplikime individuale (ose grupe pedagogësh) në projekte të financuara nga thirrje kombëtare, që synojnë promovimin e kërkimit të aplikuar në universitet **[A3.22.4, BM5, BM8]**, bazuar te numri i fakulteteve, ky numër është vetëm 4, por, gjithsesi, është inkurajues.
- Universiteti ofron një infrastrukturë më të përshtatshme për të mirëpritur organizimin e aktiviteteve ndërkombëtare në ambientet e tij, si një formë promovimi për partneritetet kërkimore. Këto aktivitete janë rezultat i marrëveshjeve të partneritetit akademik që Universiteti ka lidhur me një sërë IAL-sh kombëtare dhe ndërkombëtare **[BM1, BM10]**. Këto aktivitete kanë përmirësuar dialogun shkencor ndërkombëtar dhe shkëmbimin e përvojës në fusha kërkimore, si arsimit, vlerat ndërkulturore, bujqësia, ushqimi, mjedisi, shkencat humane, proceset e integritit social dhe ekonomik **[A 3.21]**, por, në të ardhmen, duhet të organizohen më shumë konferenca dhe në fusha të ndryshme kërkimore.
- Universiteti ka qenë partner në disa projekte ndërkombëtare në përgjigje të ofertave evropiane të kërkimit shkencor në fushat kërkimore të shkëmbimit të personelit (INACT), teknologjisë së aplikuar të informacionit, ekonomisë bujqësore, veprimeve ndërkufitare pilot të biomasës dhe mjeteve ndërkufitare për zhvillim rajonal, të nxënimit elektronik, kurrikulat e përbashkëta, rishikimit të kurrikulave, të nxënimit gjatë gjithë jetës, shkencave ekzakte, bujqësisë dhe agrobiznesit, si dhe në fushën e sipërmarrjes dhe përfshirjes së saj në kurrikulat mësimore **[A3.22]**, por shumica e këtyre projekteve shërbejnë për ngritjen e kapaciteteve dhe nuk janë projekte kërkimore të zakonshme.
- Është shumë inkurajuese që UNIKO-ja, në bashkëpunim me Universitetin e Bullgarisë, po aplikon për hapjen e një programi studimi doktorature të ri në “Gjuhësi e aplikuar dhe krahasuese” **[BM2, BM8, BM10]**.

Krahas kësaj, njësitë kryesore organizojnë gjithmonë aktivitete ceremoniale për promovimin e arritjeve të kualifikimit shkencor të personelit ose për promovimin e botimit të monografive ose librave shkollorë universitarë [<http://unkorce.edu.al/category/promovim-monografi/>]. **Kapitulli II, Standardi I. 3.**

- 4.8 Plani Strategjik i Zhvillimit i Universitetit përcakton fushat kryesore të kërkimit shkencor, ku çdo fakultet cakton objektivat kryesore përkatës dhe fushat e kërkimit shkencor në përbushje të planit të parashikuar në strategjinë e zhvillimit të UNIKO-s **[A1.3.2]**. Fushat kërkimore kryesore, ku do të fokusohet veprimtaria akademike gjatë periudhës 2022-2027, janë miratuar në dokumentin për fushat e kërkimit shkencor **[A2.6]**. Kërkimi në të gjitha këto fusha udhëhiqet nga parimi i objektivitetit të gjykimit, ndershmërisë akademike, mbështetjes argumentuese, të menduarit kritik dhe inovacionit. Departamentet hartojnë agjendat vjetore, ku përshkruhen treguesit kyç të performancës, që përfshijnë: aktivitetet shkencore, botimet, aplikimet për projekte, kërkimin e lidhur me kurrikulën, kualifikimin e personelit dhe kërkimin e aplikuar nëpërmjet bashkëpunimit shkencor në partneritet, dhe kjo është pohuar edhe gjatë takimeve me personelin akademik **[BM5]**. Aktivitetet shkencore të organizuara nga Universiteti, tryezat e rrumbullakëta dhe botimet e punimeve përmirësojnë debatin konstruktiv në fushat përkatëse të kërkimit **[RVV, f. 51]**. UNIKO-ja mbështet nismat e personelit, qoftë duke mbuluar koston e aplikimeve të tyre, duke mundësuar objektet infrastrukturore, ose duke lehtësuar përdorimin e tyre funksional të duhur. Personeli akademik është inkurajuar vazhdimisht që të marrë pjesë në trajnime për ngritjen e kapaciteteve laboratorike në kërkimin e aplikuar **[RVV, f. 51]**, por kryesisht nëpërmjet projekteve dhe me kohëzgjatje të shkurtër **[BM5, BM10]**. Në të ardhmen, UNIKO-ja duhet të favorizojë debatin shkencor në fushat parësore të kërkimit shkencor nëpërmjet organizimit të ditëve akademike, leksioneve të hapura, diskutimeve të leksioneve të reja në departamente, seminareve, ku personeli akademik të mund të angazhohet në diskutim idesh dhe arritjesh shkencore. Gjithashtu, për të rritur numrin e pedagogëve të huaj, që mund të sjellin metoda të reja kërkimi **Kapitulli II, Standardi I.4.**
- 4.9 Rektorati koordinon procesin institucional të prioritizimit të fushave kërkimore, në përputhje me Planin Strategjik të Zhvillimit të UNIKO-s, prioritetet e kërkimit të përcaktuara nga MAS-i në Strategjinë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin, dhe të nxitura nga nevojat kontekstuale të zhvillimit të njërive kërkimore **[RVV, f. 51]**. Sektori i Projekteve dhe Kërkimit Shkencor informon rreth fushave prioritare në thirrjet evropiane për projekte dhe udhëheq proceset e aplikimit në projekte **[A 1.5, BM8]**. Duke filluar nga ky vit akademik, njësitë do të zgjerojnë qasjen e tyre ndaj kërkimit duke përzgjedhur fusha kërkimi me interes dhe duke hartuar plane vjetore veprimi për realizimin e kërkimit të aplikuar dhe paraqitjen e inovacionit të mundshëm. Në këtë kontekst, UNIKO-ja ka intensifikuar bashkëpunimin e ardhshëm me Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, organet qeveritare, etj. **[RVV, f. 52]**. Gjithashtu, prioritetet kërkimore janë pasqyruar edhe te kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik të ri dhe me kohë të pjesshme, ku i është dhënë prioritet personelit të kualifikuar jashtë vendit dhe/ose personelit me grada shkencore të fituara jashtë vendit **[A1.13, A 3.14.1, BM8, BM10]** **Kapitulli II, Standardi I.5.**

- 4.10 UNIKO-ja ndjek një linjë themelore parimesh kërkimore dhe kërkimi akademik kryhet kryesisht për të mundësuar një sfond mbështetës themelor për arritjen e objektivave të programeve të studimit. Është deklaruar se UNIKO-ja i mundëson rezultate inovacioni të besueshme komunitetit të kërkuesve dhe palëve të interesit **[RVV, f. 52]**, por, në të ardhmen, nevojiten përmirësime të kërkimit **[BM6]**. Këto dy tendenca kryesore do të sigurojnë drejtime të qëndrueshme për ndërmarrje shkencore të ardhshme dhe do ta ndërgjegjësojnë personelin akademik sa i përket faktit se cilësia e kërkimit të tyre lidhet drejtpërdrejt me mirëqenien akademike institucionale dhe kontribuon ndaj përpjekjes institucionale për ta kthyer UNIKO-n në një qendër kërkimore aktive në rajon **[RVV, f. 52]**. Veprimtaria kërkimore e njëjësive analizohet si një nga tre komponentët kryesorë të veprimtarisë akademike në analizën vjetore të UNIKO-s për çdo departament. Raporti analizon masën në të cilën kërkimi i kryer kontribuon ndaj kualifikimit shkencor cilësor të personelit dhe, si rrjedhojë, përcakton procedurat mbështetëse të përshtatshme për përmirësimin e tij. UNIKO-ja vlerëson rezultatet e veprimtarive shkencore të organizuara nga njësitë dhe përcakton planet e veprimit për veprimtari të reja. Raporti rendit veprimtaritë shkencore të rëndësishme ku merr pjesë personeli dhe diskuton mjetet më të mira promovuese për këto përvoja **[BM5]**. Një prej tyre është sugjerimi i mjeteve nëpërmjet së cilave mund të përmirësohet përvoja e personelit në kërkim shkencor dhe mënyra e aplikimit të kërkimit për zhvillimin e kurrikulave **[A 3.26]**. UNIKO-ja pranon faktin se ka ardhur koha që njësitë të mendojnë rreth mënyrave se si mund të krijojnë grupe kërkimore të përshtatshme, që synojnë paraqitjen e rezultateve shkencore të aplikueshme dhe të drejtat e patentave **[RVV, f. 52]**. Për këtë nevojitet që personeli dhe autoritetet të punojnë për ngritjen e kapacitetit kërkimor të laboratorëve dhe programeve për të cilat janë duke punuar aktualisht. Personeli akademik i ri, që kryen studimet e doktoraturës në UNIKO ose në IAL të tjera në Shqipëri, është përfshirë në veprimtari mësimdhënieje akademike. Puna kërkimore e doktorantëve promovohet nëpërmjet aktiviteteve të organizuara për mbështetjen e kualifikimit të tyre dhe për paraqitjen e rezultateve të kërkimeve të tyre te një grup i gjerë palësh interesi [\[http://unkorce.edu.al/category/konferenca/\]](http://unkorce.edu.al/category/konferenca/). Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, në bashkëpunim me Universitetin South-West në Blagoevgrad, po projektton një program doktore të përbashkët në “Gjuhësi të aplikuar dhe krahasuese”. Synimi është promovimi i burimeve njerëzore nëpërmjet shkëmbimit akademik në nivel kërkimor, duke siguruar mbikëqyrje të dyfishtë për çdo doktorant **[RVV, f. 52]**. UNIKO-ja, nëpërmjet Qendrës Ndërdisciplinore të Studimeve Ballkanike, synon të integrojë kërkues të huaj për të mbështetur veprimtaritë kërkimore për Universitetin në fushën e Studimeve Ballkanike, që do të krijojë një rrjet të qëndrueshëm kërkuesish me qendrat e tjera të ngjashme **[RVV, f. 52-53]**. Megjithatë, UNIKO-ja, për të promovuar rritjen e cilësisë dhe ndërkombëtarizimit të studimeve, duhet të nxisë pjesëmarrjen e personelit akademik të huaj në mësimdhënie në formën e leksioneve të hapura dhe angazhimeve me kohë të pjesshme. Sektori i Projekteve dhe Kërkimit Shkencor nuk ka një buxhet të posaçëm, çka komplikon punën e tij **[B.M8]**. Është shembull i mirë që Sektori i Projekteve dhe Kërkimit Shkencor mbështet personelin akademik për aplikimet në projekte, megjithëse numri i personelit në këtë Sektor është i vogël për të pasur një funksionim të përshtatshëm **Kapitulli II, Standardi I.6.**
- 4.11 UNIKO-ja përkrah të gjitha njësitë që kanë për qëllim promovimin e profilit kërkimor të kërkuesve të tyre, qofshin këta kërkues me përvojë, të rinj, ose studentë të ciklit të dytë/tretë **[A3.21]** dhe, pavarësisht se disa studentë janë përfshirë në projekte

kërkimore, pjesëmarrja e tyre duhet të rritet në të ardhmen e afërt **[BM3, BM4]**. Veprimtaritë shkencore të organizuara nga departamentet dhe fakultetet jo vetëm që kanë pasuruar, por edhe kanë zgjeruar rrjetin e bashkëpunimeve në fushën e kërkimit shkencor, dhe kanë përmirësuar ndërveprimin me palët e interesit rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare **[RVV, f.53]**. Njësitë kryesore kanë filluar të përfshihen në krijimin e profileve konkrete të kërkimit dhe në organizimin e konferencave, simpoziumeve, tryezave të rumbullakëta dhe seminareve, që kontribuojnë për matjen e cilësisë së kërkimit. Cilësia e këtyre aktiviteteve po ia tejkalon sasisë dhe përvojat kërkimore të paraqitura në to prirjen të rriten nga viti në vit, për shkak se gjetjet e kërkimit në vend ndahen me një përvojë ndërkombëtare të maturuar të shqyrtimit kërkimor **[RVV, f. 53]**. Megjithatë, nevojitet një angazhim më i madh për të përmbushur nevojat e veprimtarive shkencore, veçanërisht nga kompanitë, që kanë kërkuar analiza laboratorike dhe janë në gjendje të mbështesin financiarisht studentët për punën praktike **[BM6]**. UNIKO-ja ka rritur ndjeshëm praktikën profesionale të studentëve gjatë katër viteve të fundit **[BM3]**. Gjithsesi, duhet kryer një rishikim, në mënyrë që orët e praktikave profesionale në disa njësi të rriten, bazuar te programi i studimit, pasi disa prej praktikave janë me kohëzgjatje të shkurtër **[BM4]**. Njëpërmjet botimeve shkencore, por kryesisht atyre të botuara si punime konferencash, dhe botimit të “Buletinit Shkencor” ose botimeve të veçanta të tij, është synuar rritja e ndikimit të tyre në literaturën kombëtare të botuar të kërkimit akademik. Njësitë janë angazhuar për botimin e punimeve në fusha kërkimore të caktuara, si: bujqësia, edukimi, ekonomia dhe shkencat natyrore dhe ato humane, pasi kjo gjë u jep mundësinë të botojnë artikujt e tyre në revista të profilizuara **[RVV, f. 53]**. Megjithatë, duhet të kryhen më shumë botime në revista të huaja dhe me faktor ndikimi **Kapitulli II, Standardi I.7**.

- 4.12 Bordi Shkencor i “Buletinit Shkencor” kryesohet nga Rektori dhe përbëhet nga akademikë me grada shkencore, nga UNIKO-ja ose të ftuar nga institucione të tjera të arsimit të lartë, që mbështesin, zhvillojnë dhe vlerësojnë veprimtarinë kërkimore të UNIKO-s **[RVV, f. 53]**. Gjithashtu, Bordi Shkencor përcakton rregulloren e “Buletinit Shkencor” në institucion dhe menaxhon botimet e të gjitha teksteve akademike të miratuara më parë nga departamentet përkatëse **[A1.18]**. Politikat institucionale për mbrojtjen e pronës intelektuale përcaktohen në bazë të Rregullores së Buletinit Shkencor dhe Kodit të Etikës, si dhe të udhëzimeve të brendshme të UNIKO-s, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm. Të gjitha këto rregullore parashikojnë rastet e plagjiaturës dhe bëjnë me dije autorët dhe kërkuesit për përgjegjësinë shkencore dhe dijeninë personale për cilësinë e botimeve akademike **[A1.20, A1.12]**. UNIKO-ja mbështet personelin e ri në nismat e kërkimit dhe zhvillimit duke i inkurajuar që të marrin pjesë në veprimtari shkencore, duke përkrahur njësitë e kualifikimit të tyre, duke i përfshirë në zbatim projektesh, dhe duke vlerësuar botimin e librave shkollorë **[A3.16, BM5]**. “Buletini Shkencor” është një revistë periodike e UNIKO-s, që promovon cilësinë akademike të kërkimit shkencor dhe kompetencën profesionale të personelit. Buletini publikon artikujt të pabotuar më parë, në gjuhën shqipe dhe angleze, nga autorë që janë personel i UNIKO-s dhe nga shumë kërkues të tjerë që dëshirojnë të promovojnë kërkimin e tyre cilësor <http://unkorce.edu.al/buletini/>. Sektori i Projekteve dhe Kërkimit Shkencor mban regjistra të plotë në bazën e të dhënave për veprimtarinë e Bordit Editorial, procedurat e botimit, udhëzimet për autorët, dokumentacionin e dorëzimit të punimeve, transferimin e të drejtës së autorit, formën e shqyrtimit të botimit dhe njoftimin formal të miratimit të botimit, pjesë e procedurave të botimit të kësaj reviste. Evidenca për numrin e artikujve dhe fushës përkatëse të kërkimit, si dhe për numrin e

autorëve dhe dokumentacionin përkatës, raportohet në analizën e kërkimit shkencor gjatë analizës akademike vjetore të Universitetit [RVV, f. 54, A1.30]. Megjithatë, bazuar te faqja e internetit e UNIKO-s, Këshilli Shkencor ka pedagogë vetëm nga Shqipëria dhe buletini i fundit u botua në vitin 2018. Revista dhe botimet e posaçme të saj janë në formë të shtypur dhe u dorëzohen të gjithë autorëve; kopje të sajat u dërgohen edhe bibliotekave të fakulteteve, Bibliotekës Kombëtare në Tiranë, bibliotekës së qytetit të Korçës dhe Rrjetit Kombëtar të Bashkëpunimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë. Një kopje elektronike publikohet edhe në faqen e internetit të UNIKO-s për t'ua vendosur në dispozicion kërkuesve ndërkombëtarë ose institucioneve të diasporës [RVV, f. 54; <http://unkorce.edu.al/buletini/>]. Të gjitha veprimtaritë shkencore të organizuara nga UNIKO-ja ndjekin procedurat e vlerësimit, redaktimit dhe mbulimit të plotë financiar të akteve të konferencave ose simpoziumeve [A3.17, BM5, BM10]. **Kapitulli II, Standardi I. 8.**

## Gjetje

### Praktika e mirë

- Është shumë inkurajuese që një program në fushën e Agrobiznesit ka nisur studime të dyfishta në kuadër të projektit Erasmus+, ku është planifikuar një rritje e ndjeshme e praktikave profesionale. **[Kapitulli I, Standardi II.4]**

### Pikat e dobëta

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi pikat e dobëta të mëposhtme:

- Mungesa e mbështetjes financiare për pjesëmarrje në konferenca, kongrese dhe simpoziume ndërkombëtare dhe tarifat për dorëshkrimet që do të botohen në revista me faktor ndikimi, dhe që buxheti për projektet kërkimore nuk është i mjaftueshëm. **[Kapitulli I, Standardi II.4]**

### Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- Treguesit kryesorë të performancës duhet të përfshihen në RVV. Duke filluar nga numri i studentëve të regjistruar rishtas, numri i përgjithshëm i studentëve, numri i çregjistrimeve dhe numri i diplomimeve. **[Kapitulli I, Standardi II.1]**
- UNIKO-ja duhet të rrisë aplikimet për projektet kërkimore të zakonshme nga thirrjet kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllim rritjen e numrit të projekteve kërkimore ndërkombëtare. **[Kapitulli II, Standardi I.1]**
- Numri i trajnimeve mbi mësimdhënien është i vogël, pavarësisht nevojës që pedagogët të njihen me metoda të reja mësimdhënieje. Qendra për Formimin e Vazhduar duhet të planifikojë më shumë trajnime për personelin dhe trajnuesit e personelit për të kryer trajnim shtesë rreth metodave të reja të mësimdhënies dhe, në veçanti, për mësimdhënien *online*. **[Kapitulli I, Standardi II.4]**
- Kërkuesit e rinj dhe studentët duhet të mbështeten dhe të përfshihen më shumë në projekte kërkimore dhe në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare nga stafi i nivelit të lartë. **[Kapitulli I, Standardi II.6 dhe Kapitulli I, Standardi II.7]**

- Në të ardhmen e afërt, UNIKO-ja duhet të organizojë workshop-e për personelin dhe studentët për ndërgjegjësimin rreth plagjiaturës. **[Kapitulli II, Standardi I.7]**

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimin e ndërmarrë si më poshtë:

- Është shumë inkurajuese që personeli akademik ka qenë dhe vijon të jetë i përfshirë në projekte të ndryshme Erasmus+ për ngritjen e kapaciteteve, dhe fokusi është te përmirësimi i proceseve, strukturave dhe instrumenteve për përmirësimin e kurrikulave. **[Kapitulli I, Standardi II.4]**
- Hapat që Universiteti ndërmerr për rritjen e financimit për projekte kërkimore të vogla, që mund të realizohen nga personeli i departamenteve. **[Kapitulli II, Standardi I.1]**
- Mbështetja e Qendrës për Kërkim dhe Ekselencë për personelin akademik për aplikimin në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare. **[Kapitulli II, Standardi II.6]**

**Gjykimi**

**Standardet për Kurrikulën janë përmbushur kryesisht.**

## Fusha e vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e Tyre

5.1 UNIKO-ja u kushton vëmendje të kujdesshme studentëve aktualë, regjistrimit të kandidatëve të mundshëm nga arsimiti i mesëm i lartë, si dhe përshtatjes së tyre në rrugëtimin akademik. Gjithashtu, UNIKO-ja mban kontakte të vazhdueshme me studentët për nevojat e tyre të të nxëniet, mobilitetin, rezultatet e kualifikimit profesional dhe vlerën e diplomave në tregun e punës [BM3, BM4, BM6]. Sasia dhe cilësia e studentëve është një çështje themelore diskutimi në nivelin e njësisë bazë dhe në nivelin e organeve vendimmarrëse [A 3.3, BM5, BM10]. Objektivat kryesorë të Planit Strategjik të Zhvillimit 2022-2027 po zbatohen në drejtimet e mëposhtme:

- koordinimi ndërmjet kërkesave të tregut të punës për kualifikimin me kurrikulat e ofruara nga UNIKO-ja, duke rritur nivelin e njohurive ndërmjet cikleve [A 3.33, BM2, BM6].
- mbajtja e komunikimit me institucionet e arsimit parauniversitar [A 3.4], por me rritje të fokusit të bashkëpunimi me shkollat e mesme në të ardhmen [BM6].
- komunikimi me institucionet e tregut të punës dhe vlera e diplomave [<https://www.facebook.com/unkorce/posts/5058027830888563>, BM6].
- orientimi i studentëve dhe Këshillimi për Karrierën [A 2.28, BM6].
- promovimi i ideve novatore te studentët [<https://www.youtube.com/watch?v=ye5xNm90cM4>; <https://www.facebook.com/unkorce/posts/4943260422365305>].
- angazhimi i studentëve në jetën akademike të UNIKO-s [<https://www.facebook.com/unkorce/posts/4982851861739494>], megjithëse përfshirja e studentëve në projekte kërkimore është e ngadaltë, por inkurajuese, sepse ka pasur interes nga pedagogët dhe studentët gjatë viteve të fundit [BM3, BM4, BM5, BM8, BM10].
- promovimi i veprimtarive jashtëshkollore [<https://www.facebook.com/unkorce/posts/4959595157398498>; <https://www.facebook.com/unkorce/posts/4968197719871575>; <https://www.facebook.com/unkorce/posts/4954812284543452>; <https://www.facebook.com/unkorce/posts/5044602945564385>; <https://www.facebook.com/unkorce/posts/4928865150471499>; <https://www.facebook.com/unkorce/posts/4918188641539150>; <https://www.facebook.com/unkorce/posts/4295706697120684>], që është konfirmuar nga studentët, por, në të ardhmen, nevojitet mundësimi i një hapësire më të madhe për kryerjen e veprimtarive mësimore dhe sociale për studentët [BM3, BM4].
- Procesi i pranimit dhe regjistrimit të studentëve dhe përshtatja e tyre në strukturën e programeve të studimit kryhet nga Qendra e Karrierës dhe Alumni dhe departamentet, bazuar te propozimet e tyre për kriteret dhe kuotat e pranimit, autoritetet drejtuese dhe përfaqësuesit e studentëve në organet vendimmarrëse [BM2, BM10]. Gjatë përcaktimit të kriterëve për regjistrimin e studentëve të rinj, njësitë marrin parasysh ecurinë e regjistrimeve në dy vitet e mëparshme dhe ecurinë e studentëve të regjistruar në ciklin Bachelor [BM10].

Qendra e Karrierës dhe Alumni organizon aktivitete të ndryshme, trajnime për zhvillimin në karrierë, hartim CV-sh dhe përgatitje të dosjes profesionale, paraqitje në intervista pune, si dhe u ofron studentëve asistencë për aplikimet në mobilitete dhe lehtëson transferimin e krediteve ECTS të tyre [BM3, BM4, BM9]. Qendra organizon dhe menaxhon aktivitetet e zhvilluara nga organizata, institucione dhe organe të tjera



me studentët e Universitetit, për t'i informuar mbi rolin e tyre në çështje sociale. Qendra krijon lidhje të reja me institucionet e tregut dhe ka nisur të ndërmjetësojë praktikat e studentëve

